FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 83	2003	Tetor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9129 datë 8.9.2003	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventen Universale për të drejtën e autorit" dhe dy protokollet shtesë të saj	3633
Ligj nr.9130 datë 8.9.2003	Për autoritetin portual	3645
Ligj nr.9131 datë 8.9.2003	Për rregullat e etikës në administraten publike	3660
Ligj nr.9132 datë 11.9.2003	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për transportin ndërkombëtar të kombinuar të mallrave	3665
Udhëzim i MBU nr.1, datë 15.8.2003	Për raportimin e gjendjes numerike të druëve frutore dhe dokumentet që duhen plotësuar për lejimin e prerjes së tyre	3671
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fatos Deneja	3675

L I G J
Nr.9129 datë 8.9.2003

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN UNIVERSALE PËR TË DREJTËN E AUTORIT" DHE DY PROTOKOLLET SHTESË TË SAJ

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në "Konventën Universale për të drejtën e autorit" dhe dy protokollet shtesë të saj.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3966, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONVENTA UNIVERSALE
PËR TË DREJTËN E AUTORIT
RISHIKUAR NË PARIS, MË 24 KORRIK 1971

Shtetet Kontraktuese:

me dëshirën për të siguruar në të gjitha vendet mbrojtjen e të drejtës së autorit për veprat letrare, shkencore dhe artistike;

të bindur që regjimi i mbrojtjes të së drejtës së autorit të përmirësuar në të gjitha vendet dhe të shprehura në një Konventë Universale, që i shtohet sistemeve ndërkombëtare tashmë në fuqi, pa i cenuar ato, bëhet për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe për të favorizuar zhvillimin e letërsisë, shkencës dhe arteve;

të bindur që një regjim i tillë universal mbrojtjeje të të drejtave të autorëve do ta bëjë më të lehtë shpërndarjen e veprave krijuese dhe do të kontribuojë në një mirëkuptim më të mirë ndërkombëtar, kanë vendosur të rishikojnë Konventën Ndërkombëtare mbi të drejtën e autorit të nënshkruar në Gjenevë, më 6 shtator 1952 (më poshtë e quajtur “Konventa e 1952”) dhe, si rrjedhim, shtetet bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Çdo Shtet Kontraktues angazhohet të ndërmarrë të gjitha dispozitat e nevojshme për të siguruar një mbrojtje të mjaftueshme dhe efikase të të drejtave të autorëve dhe të gjithë titullarëve të këtyre të drejtave për veprat letrare, shkencore dhe artistike, si dhe veprat muzikore, dramatike e kinematografike, pikturës, gravurës e skulpturës.

Neni 2

1. Veprat e publikuara të shtetasve të huaj të çdo Shteti Kontraktues, si dhe veprat e

publikuara për herë të parë në territorin e një shteti, gëzojnë të gjitha të drejtat, në të gjitha Shtetet Kontraktuese, mbrojtjen që ky shtet u jep veprave të shtetasve të huaj të publikuara për herë të parë në territorin e tij, si dhe mbrojtjen speciale që u jep Konventa në fjalë.

2. Veprat e papublikuara të shtetasve të huaj të çdo Shteti Kontraktues që gëzojnë të drejtën e mbrojtjes që ky shtet u jep veprave të papublikuara të shtetasve të tij, si dhe mbrojtjen speciale që i akordon Konventa në fjalë.

3. Çdo Shtet Kontraktues, mund që t'u sigurojë zbatimin e Konventës në fjalë, shtetasve të tij dhe të huaj rezidentë në shtetin e tij, nëpërmjet dispozitave të legjislacionit të tij të brendshëm.

Neni 3

1. Çdo Shtet Kontraktues, që sipas legjislacionit të brendshëm, me kusht mbrojtjen e të drejtave të autorëve, detyron plotësimin e formaliteteve, si: depozitën bankare, regjistrimin, vlerësimin, certifikatën noteriale, pagesat e taksave, fabrikimin ose publikimin në territorin kombëtar. Këto kërkesa duhet të konsiderohen si të vlefshme për çdo vepër të mbrojtur sipas afateve e kushteve të përcaktuara në Konventën në fjalë, edhe për veprat e publikuara për herë të parë jashtë territorit të këtij shteti, ku autori është shtetas i huaj që mban simbolin dhe të shoqëruar me emrin e titullarit të së drejtës së autorit, por kur vepra e tij e parë, në të gjitha kopjet e publikuara me autorizim të autorit ose të titullarit që ka të drejtat e autorit, si dhe të dhënat e vitit të parë të publikimit: simbolin, emrin dhe vitin, të cilat duhet të pasqyrohen në mënyrë të qartë që e drejta e autorit është rezervuar.

2. Dispozitat e pikës së parë nuk e pengojnë Shtetin Kontraktues të plotësojë disa kushte, me qëllim sigurimin, mbrojtjen e të drejtave të autorit, veprave të publikuara për herë të parë në territorin e tij ose veprat e shtetasve të huaj, kushdo qoftë vendi i publikimit të tyre.

3. Dispozitat e pikës së parë nuk e pengojnë Shtetin Kontraktues të kërkojë nga një person, i thirrur nga gjykata që të mund të mbrohet në procesin gjyqësor, t'u nënshtrohet rregullave dhe procedurave, si asistenca e avokatit të këtij shteti në vend të të pandehurit ose depozitimi nga i pandehuri i një kopjeje të veprës pranë gjykatës ose zyrave administrative apo në të dyja vendet njëkohësisht. Në rast të mospërmbushjes së këtyre kërkesave nuk e prek vlefshmërinë e të drejtës së autorit. Asnjë nga këto kërkesa nuk mund t'i imponohet një shtetasi të huaj të një Shteti tjetër Kontraktues, në rast se kjo kërkesë nuk bëhet edhe për shtetas të shtetit, në të cilin kërkohet mbrojtja e të drejtës së autorit.

4. Në çdo Shtet Kontraktues duhet të sigurohen mjetet juridike për mbrojtjen, pa formalitete të veprave jo të publikuara të shtetasve të shteteve të tjera kontraktuese.

5. Në rast se një Shtet Kontraktues akordon më shumë se një periudhë mbrojtjeje dhe në qoftë se periudha e parë, ka një kohëzgjatje më shumë se minimumi i kohës së parashikuar në nenin 4 të Konventës në fjalë, ky shtet ka mundësinë e mosaplikimit të nënpikës 1 të këtij neni, lidhur me periudhën e dytë të mbrojtjes, si dhe për periudhat në vazhdim.

Neni 4

1. Kohëzgjatja e mbrojtjes së veprës rregullohet nëpërmjet ligjit të Shtetit Kontraktues, ku kërkohet mbrojtja, sipas dispozitave të nenit 2 dhe të dispozitave të mëposhtme.

2. a) Kohëzgjatja e veprave të mbrojtura nga Konventa në fjalë nuk do të jetë më e ulët se mosha e autorit duke i shtuar edhe njëzet e pesë vjet pas vdekjes. Megjithatë, Shteti Kontraktues, i cili, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në territorin e tij, mund ta zvogëlojë këtë afat për një kategori veprash, duke u nisur në përllogaritje nga publikimi i parë i veprës. Gjithashtu shteti ka të drejtë t'i ruajë këto afate ose t'i shtrijë në kategori të tjera. Për të gjitha këto kategori, kohëzgjatja e mbrojtjes nuk do të jetë më shumë se njëzet e pesë vjet duke u nisur nga data e parë e publikimit të veprës.

b) Çdo Shtet Kontraktues, i cili, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në territorin e tij, nuk e llogarit kohëzgjatjen e mbrojtjes mbi bazën e jetës së autorit, shteti ka të drejtë të përllogarisë kohëzgjatjen duke u nisur nga data e publikimit të parë të veprës ose, në rast nevoje, kohën e regjistrimit paraprak të publikimit; kohëzgjatja e mbrojtjes nuk do të jetë më pak se njëzet e pesë vjet duke u nisur nga data e parë e publikimit ose, në rast nevoje duke u nisur nga koha e regjistrimit paraprak të publikimit.

c) Në rast se Shteti Kontraktues parashikon dy ose më shumë periudha të njëpasnjëshme mbrojtjeje, kohëzgjatja e periudhës së parë nuk do të jetë më pak se kohëzgjatja minimale e njërës nga periudhat e përcaktuara në pikat (a) dhe (b) të lartpërmendura.

3. Dispozitat e pikës 2 nuk do të aplikohen njëlloj për veprat fotografike dhe për veprat e artit të aplikuar. Megjithatë, për Shtetet Kontraktuese, që mbrojnë veprat fotografike, duke i konsideruar si vepra artistike edhe veprat e artit të aplikuar, kohëzgjatja për mbrojtjen e këtyre veprave nuk do të jetë më pak se dhjetë vjet.

4.a) Asnjë Shtet Kontraktues nuk do të sigurojë mbrojtjen e një vepre më gjatë sesa kohëzgjatja e fiksuar sipas kategorisë së veprave, që parashikon ligji i këtij shteti për autorët që janë shtetas të huaj. Kjo pikë aplikohet në rast se bëhet fjalë për një vepër të papublikuar dhe për veprat e publikuara për herë të parë sipas ligjit të Shtetit Kontraktues.

b) Me qëllim aplikimi të pikës (a) në rast se Shteti Kontraktues parashikon dy ose më shumë periudha të njëpasnjëshme mbrojtjeje, kohëzgjatja e mbrojtjes që aplikon ky shtet konsiderohet si shumë e këtyre periudhave. Megjithatë, në rast se për një arsye çfarëdo, një vepër e caktuar nuk është e mbrojtur nga shteti për periudhën e dytë ose një nga periudhat në vazhdim, shtetet e tjera kontraktuese nuk janë të detyruara ta mbrojnë veprën për këtë periudhë të pa mbrojtur.

5. Me qëllim aplikimi të nënpikës 4, vepra e një shtetasi të një Shteti Kontraktues, e publikuar për herë të parë në një shtet jokontraktues, do të konsiderohet si vepër e publikuar për herë të parë në këtë Shtet Kontraktues, autori i të cilit është shtetas i huaj.

6. Me qëllim aplikimi të nënpikës 4, cituar më lart, në rastet e publikimit të njëkohshëm në dy ose më shumë Shtete Kontraktuese, vepra do të konsiderohet si publikim për herë të parë në atë shtet, i cili aplikon mbrojtje me kohëzgjatje më të vogël. Publikimi i njëkohshëm në disa vende konsiderohet:

çdo vepër që del në qarkullim në tridhjetë ditët e para të publikimit të saj të parë, në dy ose më shumë vende.

Neni 4 bis

1. Të drejtat e parashikuara në nenin e parë përmbajnë të drejtat themelore, që sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të trashëgimisë së autorit, veçanërisht të drejtën eksluzive të autorizimit të riprodhimit me çdo lloj mjeti, paraqitjen dhe përdorimin publik dhe radiodifuzionin. Dispozitat e këtij neni aplikohen për veprat e mbrojtura nga kjo Konventë, si në formën e tyre origjinale, ashtu dhe në formën që njihet si e prejardhur nga vepra origjinale.

2. Megjithatë, çdo Shtet Kontraktues, me legjislacionin e tij kombëtar, mund të parashikojë përjashtime, por jo në kundërshtim me dispozitat e kësaj Konvente dhe të drejtave që parashikon nënpika 1 e këtij neni. Shtetet duke pasur këtë mundësi duhet, megjithatë, të bëjnë përjashtime në akordimin e të drejtave, me kusht që të ruajnë një nivel të arsyeshëm mbrojtjeje efektive.

Neni 5

1. Të drejtat e parashikuara në nenin 1 përfshijnë të drejtën ekskluzive të publikojnë dhe të autorizojnë për të publikuar përkthimin e veprave të mbrojtura sipas kësaj Konvente.

2. Megjithatë, çdo Shtet Kontraktues mund, që nëpërmjet legjislacionit të tij, të ngushtojë për shkrimet, të drejtën e përkthimit, por duke iu përshtatur dispozitave të mëposhtme:

a) Në rastet kur kalohet afati shtatë vjet, që nga data e publikimit të parë të një shkrimi dhe kur përkthimi i tij nuk është publikuar në një gjuhë të përdorimit të përgjithshëm në Shtetin Kontraktues nga titullari i të drejtës së përkthimit ose me autorizimin e tij, çdo qytetar i këtij Shteti Kontraktues mund të pajiset nga autoritetet kompetente të këtij shteti me një licencë joekskluzive për të përkthyer veprën në këtë gjuhë dhe për ta publikuar.

b) Kjo licencë i akordohet një kërkuesi, i cili, sipas dispozitave në fuqi të shtetit ku është bërë kërkesa, vërteton marrjen nga titullari i të drejtës së përkthimit, autorizimin e përkthimit dhe të botimit të tij.

Në të njëjtat kushte licenca mund t'i jepet kërkuesit, për një përkthim të botuar në një gjuhë të përdorshme të Shtetit Kontraktues, kur botimi ka mbaruar.

c) Në qoftë se titullari i të drejtës nuk arrin të marrë licencën nëpërmjet kërkesës, ai duhet t'i dërgojë kopjet e kërkesës botuesit të veprës dhe përfaqësuesit diplomatik ose konsullor të shtetit, kur

titullari i të drejtës së përkthimit është qytetar i tyre. Në raste të tilla mund t'i drejtohesh edhe organizmave që përcaktohen nga qeveria e këtij shteti. Licenca nuk mund të jepet para afatit dy mujor, duke u nisur nga data e dërgimit të kërkesës.

d) Legjislacioni kombëtar do të adoptojë masat e duhura për t'i siguruar titullarit të së drejtës së përkthimit një shpërblim të paanshëm dhe pagesa e transfera e këtij shpërblimi duhet të jetë konform përdoruesve ndërkombëtarë, me qëllim që të garantohet një përkthim korrekt i veprës.

e) Titulli dhe emri i autorit të veprës origjinale duhet që të shtypet në të gjitha kopjet e përkthyera të botuara. Licenca është e vlefshme vetëm për botime brenda territorit të Shtetit Kontraktues. Importimi dhe shitja e kopjeve në një shtet tjetër kontraktues bëhet i mundur, në rast se ky shtet ka një përvojë të gjatë në përkthimin e veprave, nëse ligji i këtij shteti njeh licencën dhe, nëse asnjë nga dispozitat në fuqi në këtë shtet nuk kundërshton importimin dhe shitjen. Importimi dhe shitja në territoret e çdo Shteti Kontraktues, ku kushtet e parashtruara nuk funksionojnë, atëherë këto kushte i rezervohen legjislacionit të këtij shteti dhe marrëveshjeve që ka kryer ky shtet. Vetëm përfituesi mund të heqë dorë nga licenca.

f) Licenca nuk mund të jepet, në rast se autori tërheq nga qarkullimi kopjet e veprës.

Neni 5 bis

1. Çdo Shtet Kontraktues, që konsiderohet si vend në zhvillim, në konformitet me praktikën e aplikuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara mund, që nëpërmjet një njoftimi të paraqitur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për edukimin, shkencën dhe kulturën (më tej e quajtur Drejtori e Përgjithshme) në momentin e ratifikimit, të pranimit ose të aderimit të tij, ose përfundimisht, të mos pranojë të gjitha, një ose një pjesë të përjashtimeve të parashikuara në nenet 5 dhe 6.

2. Çdo njoftim i depozituar konform dispozitave të nënpikës 1 mbetet në fuqi për një periudhë dhjetëvjeçare duke u nisur nga data e hyrjes në fuqi të Konventës në fjalë ose për çdo pjesë të kësaj periudhe dhjetëvjeçare, duke u nisur gjithnjë nga data e depozitimit të njoftimit, dhe mund të rinovohet e gjitha ose në pjesë për periudha të tjera dhjetëvjeçare, kërkesë e cila bëhet pesë ose tre muaj para mbarimit të afatit dhjetëvjeçar që është në vazhdim. Shteti Kontraktues depoziton një kërkesë të re pranë Drejtorisë së Përgjithshme. Gjithashtu, njoftime mund të depozitohen për herë të parë edhe gjatë periudhave të reja dhjetëvjeçare konform dispozitave të këtij neni.

3. Megjithë dispozitat e nenit 2, një Shtet Kontraktues që nuk quhet më shtet në zhvillim, nuk i njihet më lehtësia e rinovimit të njoftimit, që depoziton sipas nënpikave 1 dhe 2 dhe që ai ta anulojë ose jo këtë njoftim. Ky shtet humbet gjithashtu mundësitë për të parashikuar përjashtime që paraqiten në nenet 5 e 4 si për dhjetëvjeçarin në vazhdim, ashtu dhe për trevjeçarin që vazhdon të quhet vend në zhvillim, afat i fundit i cili aplikohet.

4. Kopjet e një vepre, tashmë të prodhuara sipas përjashtimeve të parashikuara në nenet 5 (të tretë) dhe V (të katërt) mund të vazhdojnë të jenë në qarkullim pas mbarimit të periudhës që njoftimet, për të cilat flet ky nen hyjnë në fuqi deri në mbarimin e tyre.

5. Çdo Shtet Kontraktues, që ka depozituar një kërkesë konform nenit 13 përsa i përket aplikimit të kësaj Konvente në një vend ose territor të veçantë, ku situata mund të konsiderohet analoge me shtetin në zhvillim (të përcaktuar në nënpikën 1 të këtij neni), gjithashtu, mund të depozitojë njoftime përjashtimi dhe rinovimi duke u mbështetur në këtë nen. Gjatë kohës që këto njoftime janë në fuqi, dispozitat e neneve V(të tretë) dhe V (të katërt) mund të aplikohen në këto vende ose territore. Çdo dërgim kopjesh në provinca të këtyre vendeve ose territoreve të Shtetit Kontraktues do të konsiderohen si një eksportim sipas rregullave të parashtruara në nenet V (të tretë) dhe V (të katërt).

Neni 5 (i tretë)

1.a) Çdo Shtet Kontraktues në të cilin aplikohet nënpika 1 e nenit 5 bis mund të zëvendësojë periudhën e shtatë viteve të parashikuara në nënpikën 2 të nenit 5 me një periudhë tre vjeçare ose më të gjatë që përcaktohet në legjislacionin kombëtar.

Megjithatë, në rast të një përkthimi në një gjuhë jo shumë të përdorshme në një ose më shumë vende të zhvilluara, pjesë ose e kësaj Konvente, ose vetëm e Konventës së 1952, periudha e një viti

zëvendësohet me periudhën e lartpërmendur trevjeçare.

b). Çdo Shtet Kontraktues, ku aplikohet nënpika 1 e nenit 5 bis mund, që në marrëveshje unanime me vendet e zhvilluara, nënshkruese të kësaj Konvente ose vetëm të 1952 dhe ku e njëjta gjuhë është e një përdorimi të gjerë, zëvendësuar në rastin e përkthimit në këtë gjuhë, periudha trevjeçare e parashikuar në nënpikën (a), me një periudhë tjetër konform marrëveshjes, periudha e re e përcaktuar nuk do të jetë më pak se një vit. Kjo dispozitë nuk aplikohet kur bëhet fjalë për gjuhët anglisht, spanjisht ose frëngjisht. Njoftimi i kësaj marrëveshjeje bëhet në Drejtorinë e Përgjithshme.

c) Licenca jepet vetëm në rast se kërkuesi, konform dispozitave në fuqi në shtetin ku është bërë kërkesa, justifikon ose që ka marrë autorizimin e titullarit të së drejtës së përkthimit, ose përpjekjet që ka bërë nga ana e tij dhe nuk ka mundur të kontaktojë titullarin e të drejtës ose marrjen e autorizimit. Në të njëjtën kohë që kërkuesi bën këtë kërkesë duhet të njoftojë Qendrën Ndërkombëtare të Informimit mbi të drejtën e autorit krijuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë ose çdo qendër kombëtare apo rajonale informimi të njohura si të tilla me një notë, të depozituar për këtë qëllim, pranë Drejtorit të Përgjithshëm nga qeveria e shtetit, ku botuesit i është besuar pjesa më e madhe e këtyre aktiviteteve profesionale.

d) Në rast se kërkuesi nuk ka mundur të kontaktojë titullarin e të drejtës së përkthimit, ai duhet t'i adresohet, me postë të sigurt, duke i dërguar kopje të kërkesës së tij botuesit, si dhe të gjitha qendrave kombëtare ose rajonale të informimit të cituara në pikën (c). Në rast se ekzistenca e këtyre qendrave nuk njihet, kërkuesi i drejton gjithashtu një kopje të kërkesës Qendrës Ndërkombëtare të Informimit mbi të drejtën e autorit, qendër e krijuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë.

2. a) Licenca nuk mund të jepet në bazë të këtij neni para mbarimit të afatit shtesë prej gjashtë muajsh, në rastin kur ajo mund të ishte dhënë me mbarimin e periudhës trevjeçare dhe afatin shtesë prej nëntë muajsh, në rastin kur licenca është marrë me mbarimin e periudhës njëvjeçare.

Afati shtesë fillon duke u nisur ose nga data e kërkesës së autorizimit për përkthim, siç shprehet në pikën (c) të nënpikës 1, ose, në rast se identiteti apo adresa e titullarit të së drejtës së përkthimit nuk janë të njohura, afati shtesë fillon që nga data e dërgimit të kopjeve të kërkesës, siç shprehet në pikën (d) të nënpikës 1, për marrjen e licencave.

b) Licenca nuk jepet në rast se një përkthim është botuar nga titullari i të drejtave ose me autorizim të tij gjatë afatit të shprehur më lart prej gjashtë ose nëntë muajsh.

3. Çdo licencë e dhënë sipas këtij neni konsiderohet përjashtim dhe nuk mund të jetë veçse për përdorim shkollor, universitar ose kërkimor.

4.a) Licenca nuk shtrihet për eksportimin e kopjeve dhe ajo është e vlefshme vetëm për botime brenda territorit të Shtetit Kontraktues, ku licenca është kërkuar.

b) Çdo kopje e botuar konform një licence të tillë, duhet të pajiset me një shënim në një gjuhë të njohur, ku precizohet, që kopjet vihen në dispozicion vetëm në Shtetin Kontraktues, i cili ka dhënë licencën. Në rast se vepra mban shënimin e precizuar në nënpikën 1 të nenit 3, kopjet e botuara në këtë mënyrë duhet të kenë të njëjtin shënim.

c) Ndalimi i eksportimit, siç parashikohet në pikën (a), nuk aplikohet kur një organizëm qeveritar ose çdo organizëm tjetër publik i një shteti, që ka akorduar një licencë për përkthimin e veprës në një gjuhë tjetër (jo anglisht, spanjisht apo frëngjisht), dërgohen kopje të përkthyera sipas licencës së marrë në një vend tjetër. Në këtë rast do të mbahet parasysh që:

- i) Destinuesit të jenë qytetarë të Shtetit Kontraktues, që ka dhënë licencën ose organizata që grupojnë këta shtetas.
- ii) Kopjet duhet të përdoren vetëm për përdorim shkollor, universitar ose kërkimor.
- iii) Dërgimi i kopjeve dhe shpërndarja e tyre përdoruesve nuk duhet të ketë karakter fitimprurës.
- iv) Një marrëveshje, e cila i njoftohet Drejtorit të Përgjithshëm nëpërmjet ndonjë personi të qeverive që e kanë konkluduar, të veprojë në vendet, ku kopjet janë dërguar dhe ku Shteti Kontraktues duhet që t'i lejojë, t'i pranojë dhe t'i shpërndajë ato ose të ushtrojë njërin nga këto aktivitete.

5. Dispozitat e përshtatshme aplikohen në plan kombëtar me qëllim që:

a) Licenca të përmbajë një shpërblim të drejtë dhe konform shkallës së të ardhurave normale të derdhura në rastet e licencave të negociatave të lira ndërmjet dy palëve të interesuara ndërmjet dy vendeve përkatëse.

b) Shpërblimi për veprën paguhet. Në qoftë se ekziston një rregullore kombëtare në fushën e

valutës, autoriteti kompetent nuk do të ketë asnjë problem në referimin e mekanizmave ndërkombëtarë për sigurimin e transmetimit të shpërblimit në monedhë ndërkombëtare të konvertueshme ose në ekuivalencën e saj.

6. Çdo licencë, dhënë nga një Shtet Kontraktues, mbaron afatin e veprimit, kur përkthimi i një vepre në të njëjtën gjuhë, esencialisht me të njëjtën përmbajtje të botimit, për të cilën është dhënë edhe licenca nga titullari i të drejtës së përkthimit ose me autorizimin e tij, duhet të shitet me një çmim të ngjashëm me atë të përdorimit në këtë shtet për vepra analoge. Kopjet e prodhuara para mbarimit të licencës mund të vazhdojnë të qarkullojnë deri në mbarim të tyre.

7. Për veprat, që janë kompozuar kryesisht me ilustrime, një licencë për përkthim të tekstit dhe për riprodhim të ilustrimeve mund të jepet vetëm nëse plotësohen kushtet që parashtron neni 5 (i katërt).

8. a) Një licencë për përkthim të një vepre të mbrojtur nga Konventa në fjalë, të publikuar në formë doreshkrimi (me disenjo) ose në forma analoge riprodhimi, gjithashtu mund të akordohet nga një organizëm radiodifusioni, që e ka selinë në territorin e një Shteti Kontraktues ku aplikohet neni 5 bis. Kjo është e mundur, pasi t'i jetë bërë një kërkesë këtij shteti nga ky organizëm, me kushtet e mëposhtme:

i) Përkthimi duhet të bëhet duke u nisur nga një kopje e prodhuar konform ligjeve të Shtetit Kontraktues.

ii) Përkthimi duhet të përdoret vetëm për emisione të destinuara ekskluzivisht për mësimdhënie ose për përhapjen e informacioneve me karakter shkencor për ekspertë të një profesioni të caktuar.

iii) Përkthimi duhet të përdoret ekskluzivisht për qëllime të cituara në pikën (ii) më lart nga radiodifuzues legalë, që kanë qëllim përfitimi në territorin e Shtetit Kontraktues, ku nënkuptohen mënyrat e regjistrimeve zanore ose vizuale të realizuara ligjërisht dhe ekskluzivisht.

iv) Regjistrimet zanore ose vizuale të një vepre të përkthyer mund të bëhen objekt këmbimesh vetëm ndërmjet organizmave të radiodifuzionit, që kanë selinë e tyre në territorin e Shtetit Kontraktues, që ka dhënë një licencë të tillë.

v) Çdo përdorim i përkthimeve duhet të jetë i përjashtuar nga karakteri përfitues.

b) Nën rezervën, që të gjitha kriteret dhe të gjitha kushtet e numëruara në nënpikën (a) që duhet të respektohen, një licencë mund t'i akordohet gjithashtu një organizmi radiodifuzues për përkthim të çdo teksti të integruar në regjistrime audiovizuale të botuara me qëllim përdorimi shkollor ose universitar.

c) Në rezervë të pikave (a) dhe (b), dispozitat e tjera të këtij neni janë të aplikueshme për marrjen dhe ushtrimin e një licence të tillë.

9. Në rezervë të dispozitave të këtij neni, çdo licencë e akorduar për këtë qëllim do të përcaktohet nga kërkesat e nenit 5 e do të vazhdojë të rregullohen nga dispozitat e nenit 5 e këtij neni edhe pas periudhës shtatëvjeçare të parashikuar në nënpikën 2 të nenit 5. Megjithatë, pas mbarimit të kësaj periudhe, titullari i licencës mund të kërkojë që t'i zëvendësohet me një licencë të përcaktuar ekskluzivisht nga neni 5.

Neni 5 (i katërt)

1. Çdo Shtet Kontraktues, ku aplikohet nënpika 1 e nenit 5 bis mund të adoptojë dispozitat e mëposhtme:

a) Në qoftë se, me mbarimin e afatit: (i) të periudhës së fiksuar në pikën (c) kalkuluar, që nga botimi i parë i një vepre të përcaktuar të një vepre letrare, shkencore ose artistike të parashikuara në nënpikën 3; ose (ii) të periudhës më të gjatë të fiksuar nga legjislacioni kombëtar i shtetit. Kur kopje të këtij botimi nuk gjenden në këtë shtet për t'iu përgjigjur nevojave ose të një publiku të gjerë, ose arsimit shkollor e universitar, me një çmim të ngjashëm me veprat analoge që janë në përdorim. Çdo shtetas i huaj i këtij vendi, nëpërmjet titullarit të së drejtës së riprodhimit ose me autorizimin e tij, mund të marrë nga autoritetet kompetente, një licencë joekskluzive për të publikuar këtë botim, me këtë çmim ose me një çmim më të ulët, për t'iu përgjigjur kërkesave të arsimit shkollor e universitar. Kjo licencë lëshohet kur vërtetohet që kërkuesi ka bërë përpjekje që të marrë autorizim nga titullari i të drejtës, për botimin e kësaj vepre. Në të njëjtën kohë që personi bën kërkesën, duhet të informojë gjithashtu Qendrën Ndërkombëtare të Informimit mbi të drejtën e autorit, krijuar nga Organizata e

Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë, ose çdo qendër kombëtare ose rajonale informimi cituar në pikën (d).

b) Licenca mund të jepet gjithashtu edhe në rastet kur, gjatë një periudhe gjashtëmujore, kopjet e autorizuara për botim nuk kanë dalë në shitje në shtetin përkatës për t'iu përgjigjur nevojave të publikut të gjerë ose për arsim shkollor e universitar, me një çmim të krahasueshëm me atë të veprave analoge që janë në përdorim në këtë shtet.

c) Periudha së cilës i përket pika (a) parashikon një afat prej pesë vjetësh.

Rrjedhimisht:

i) Për veprat e shkencave ekzakte dhe natyrore dhe të teknologjisë, kjo periudhë do të jetë prej tre vitesh.

ii) Për veprat që i përkasin fushës së imagjinatës të tilla, si romane, vepra poetike, dramatike e muzikore dhe për librat e artit kjo periudhë do të jetë shtatë vjet.

d) Në qoftë se titullari i të drejtës së riprodhimit nuk ka mundur të kontaktojë me kërkuesin, ky i fundit duhet që t'i dërgojë me postë të sigurt, kopje të kërkesës botuesit, emri i të cilit figuron në vepër dhe në çdo qendër kombëtare ose rajonale informimi, të njohura si të tilla nga shteti, ku botuesi ushtron pjesën më të madhe të aktiviteteve të tij profesionale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme.

Në mungesë të një njoftimi të tillë, ai dërgon gjithashtu një kopje të kërkesës në Qendrën Ndërkombëtare të Infomimit mbi të drejtën e autorit, krijuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukimin, kulturën dhe shkencën. Licenca nuk lëshohet para mbarimit të afatit tremujor duke filluar nga koha që është nisur kërkesa.

e) Licenca merret para mbarimit të këtij afati vetëm në emër të këtij neni:

i) Me mbarimin e afatit gjashtëmujor, nga koha e bërjes së kërkesës për autorizim, siç theksohet në pikën (a) ose në rastet kur nuk njihet adresa ose identiteti i titullarit të së drejtës së riprodhimit, ose sipas shpjegimeve të bëra në pikën (d) me qëllim marrjen e licencës.

ii) Në rast se gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur qarkullim të kopjeve të botimit si në kushtet e parashtruara në pikën (a).

f) Emri i autorit dhe titulli i botimit të veprës duhet të shtypen në të gjitha kopjet e riprodhuara. Licenca nuk zgjatet në eksportimin e kopjeve, licenca është e vlefshme vetëm për botimin brenda territorit të Shtetit Kontraktues ku është kërkuar. Vetëm përfituesi mund të heqë dorë nga licenca.

g) Për të siguruar një riprodhim ekzakt të botimit, legjislacioni kombëtar duhet të adoptojë masa të përshtatshme.

h) Një licencë me qëllim riprodhimi dhe publikimi të përkthimit të një vepre nuk lëshohet, sipas këtij neni në rastet e mëposhtme:

i) në rast se përkthimi, për të cilin bëhet fjalë, nuk është publikuar nga titullari i të drejtës së autorit ose me autorizimin e tij;

ii) në rast se përkthimi nuk është në një gjuhë të përdorshme në shtetin që ka mundësinë e dhënies së licencës.

2. Dispozitat që duhen aplikuar për përjashtimet e parashikuara në nënpikën 1 të këtij neni:

a) Çdo kopje e publikuar konform licencës së akorduar sipas këtij neni, duhet të përmbajë një njoftim në gjuhë të përshtatshme, ku të precizohen, që kopjet vihen në dispozicion vetëm në Shtetin Kontraktues, ku kjo licencë është e aplikueshme; në qoftë se vepra mban njoftimin e përcaktuar në nënpikën 1 të nenit 3, kopjet e publikuara duhet të kenë të njëjtin shënim.

b) Dispozitat e përshtatshme do të merren duke u mbështetur në planin kombëtar që:

i) Licenca përmban një shpërblim të paanshëm dhe konform shkallës së taksave të derdhura në rastet e licencave të negociuara lirisht ndërmjet të interesuarve në të dy vendet përkatëse.

ii) Shpërblimi për veprën paguhet. Në qoftë se ekziston një rregullore kombëtare në fushën e valutës, autoriteti kompetent nuk do të ketë asnjë problem në referimin e mekanizmave ndërkombëtarë për sigurimin e transmetimit të shpërblimit në monedhë të konvertueshme ose në ekuivalentën e saj.

c) Në çdo rast që kopjet e botimit të një vepre janë vënë në shitje në Shtetin Kontraktues për t'iu përgjigjur nevojave ose të një publiku të gjerë, ose të arsimit shkollor dhe universitar, nga titullari i të drejtës së riprodhimit ose me autorizim të tij, me një çmim të ngjashëm me një vepër analoge që shitet në këtë shtet. Çdo licencë e dhënë në bazë të këtij neni përfundon në rast se botimi është në të njëjtën gjuhë të publikuar në bazë të licencës dhe në rast se përmbajtja është esencialisht e njëjtë. Kopjet tashmë të prodhuara mund të vazhdojnë të vihen në qarkullim deri në mbarimin e tyre.

d) Licenca nuk mund të jepet kur autori tërheq nga qarkullimi të gjitha kopjet e botimit.

3. a) Me rezervë dispozitat e pikës (d), veprat letrare, shkencore ose artistike për të cilat aplikohet ky nen janë të limituara për veprat e publikuara si libër ose në çdo formë tjetër riprodhimi.

b) Ky nen është gjithashtu i aplikueshëm për riprodhime audiovizuale, fiksime të ligjshme audiovizuale duke qenë se futen në vepra të mbrojtura. Përkthimi i tekstit që i shoqëron në një gjuhë të përdorshme në shtetin që jep licencën, duke qenë sigurisht që fiksimet audiovizuale në fjalë bëhen dhe publikohen vetëm për qëllim përdorimi shkollor dhe universitar.

Neni 6

Fjala "botim" në këtë Konventë nënkupton riprodhimin në formë materiale dhe vënien në dispozicion të publikut të kopjeve të veprës për lexim ose për të marrë njohuri vizuale.

Neni 7

Kjo Konventë, nuk aplikohet për veprat ose për të drejtat mbi një vepër të cilat, në kohën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në Shtetin Kontraktues, ku mbrojtja është kërkuar, kanë përfunduar së qeni të mbrojtura në këtë shtet ose nuk kanë qenë asnjëherë të mbrojtura.

Neni 8

1. Kjo Konventë, që mban datën 24 korrik 1971, do të depozitohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme e mbetet e hapur për nënshkrim nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse të Konventës së 1952 për një periudhë njëzet vjetësh duke filluar nga data që mban Konventa. Ajo do t'i nënshtrohet ratifikimit ose pranimit të shteteve nënshkruese.

2. Çdo shtet që nuk ka nënshkruar këtë Konventë mund të aderojë.

3. Ratifikimi, pranimi ose aderimi hyn në veprim pas depozitimit të instrumenteve për këtë qëllim, pranë Drejtorit të Përgjithshëm.

Neni 9

1. Kjo Konventë hyn në fuqi tre muaj pas depozitimit të dymbëdhjetë instrumenteve të ratifikimit, pranimit ose aderimit.

2. Pas kësaj, kjo Konventë hyn në fuqi, për çdo shtet, tre muaj pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit specifik të këtij shteti.

3. Aderimi në këtë Konventë i një shteti jopjesëmarrës i Konventës së 1952 përbën njëkohësisht një aderim në të ashtëquajturën Konventë. Gjithsesi, në rast se instrumenti i tij i aderimit depozitohet para hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, aderimi i këtij shteti në Konventën e 1952 mund të vihet në varësi të hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente asnjë shtet nuk mund të aderojë në Konventën e 1952.

4. Lidhjet midis shteteve pjesëmarrëse në Konventën në fjalë dhe shtetet që kanë marrë pjesë vetëm në Konventën e 1952 përcaktohen nga Konventa e 1952. Megjithatë, çdo shtet pjesëmarrës vetëm në Konventën e 1952 mund të deklarojë nëpërmjet një njoftimi të depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm, që pranon aplikimin e Konventës së 1971 për veprat e shtetasve të tij ose veprave të publikuara për herë të parë në territorin e tij nga çdo shtet pjesëmarrës i kësaj Konvente.

Neni 10

1. Çdo Shtet Kontraktues angazhohet të marrë, konform dispozitave të kësaj Konvente, masat e nevojshme për aplikimin e saj.

2. Nënkuptohet që në datën kur kjo Konventë hyn në fuqi për një shtet, ky shtet duhet të jetë në gjendje, që sipas legjislacionit kombëtar, të aplikojë dispozitat e kësaj Konvente.

Neni 11

1. Është krijuar një komitet ndërqeveritar që ka atributet e mëposhtme:

a) të studiojë problemet lidhur me aplikimin dhe funksionimin e Konventës Universale;

b) të përgatisë përmbledhjet periodike të kësaj Konvente;

c) të studiojë çdo lloj problemi lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare të së drejtës së autorit, në bashkëpunim me organizma të ndryshëm ndërkombëtarë të interesuar veçanërisht me Organizatën e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë, Unioni Ndërkombëtar për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike dhe Organizatën e Shteteve Amerikane.

d) të njoftojë shtetet pjesëmarrëse të Konventës Universale mbi punët e tyre.

2. Komiteti është i përbërë nga përfaqësues të tetëmbëdhjetë shteteve pjesëmarrëse në këtë Konventë ose të asaj të 1952.

3. Komiteti përcaktohet duke u mbështetur në një ekuilibër të drejtë midis interesave kombëtare mbi bazën e pozicionit gjeografik të popullsisë, të gjuhëve dhe shkallës së zhvillimit.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë, Drejtori i Përgjithshëm i Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Shteteve Amerikane ose përfaqësuesit e tyre mund të asistojnë në seancat e komitetit me zë konsulativ.

Neni 12

Komiteti ndërqeveritar thërret konferenca rishikimi, çdo herë, që ato e mendojnë të nevojshme ose në rast se mbledhja është kërkuar të paktën nga dhjetë shtete pjesëmarrëse të kësaj Konvente.

Neni 13

1. Çdo Shtet Kontraktues, mund që në momentin e depozitimit të intrumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit, apo në vazhdim deklaron, nëpërmjet një njoftimi të adresuar Drejtorit të Përgjithshëm, që Konventa në fjalë është e aplikueshme për të gjitha ose për një pjesë të vendeve apo territoreve që kanë marrëdhënie me vendet e huaja. Konventa do të aplikohet në vendet ose territoret e shënuara në njoftim duke u nisur nga koha e mbarimit të tremujorit të parashikuar në nenin 9. Në të kundërt kjo Konventë nuk aplikohet në këto vende apo territore.

2. Megjithatë, ky nen nuk mund të interpretohet si pranim i heshtur nga ndonjë Shtet Kontraktues, ku kjo Konventë është bërë e aplikueshme nga një Shtet Kontraktues në bazë të këtij neni.

Neni 14

1. Çdo Shtet Kontraktues do të ketë mundësi të denoncojë këtë Konventë në emrin e tij ose në emër të të gjitha ose të një pjese vendesh apo territoresh, të cilat bëjnë një njoftim të parashikuar në nenin 13. Kallëzimi bëhet nëpërmjet një njoftimi të adresuar Drejtorit të Përgjithshëm. Ky kallëzim aplikohej edhe në Konventën e 1952.

2. Ky denoncim, kundrejt shtetit, vendit ose territorit në emër të të cilit ajo është bërë, ka efekt vetëm dymbëdhjetë muaj pas datës së marrjes së njoftimit.

Neni 15

Çdo ndryshim ndërmjet dy ose më shumë Shtetesh Kontraktuese lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Konvente, kur nuk rregullohet me bashkëbisedime, do t'i paraqitet Gjykatës Ndërkombëtare për të marrë vendim, në rast se shtetet në mosmarrëveshje nuk gjejnë një mënyrë tjetër mirëkuptimi.

Neni 16

1. Konventa në fjalë do të bëhet në frëngjisht, në anglisht dhe në spanjisht. Të tre tekstet do të

nënshkruhen dhe do të jenë të barasvlefshme.

2. Tekstet zyrtare të kësaj Konvente do të përpilohen nga Drejtori i Përgjithshëm, pas konsultimesh edhe me qeveritë e interesuara në gjermanisht, arabisht, italisht dhe në portugalisht.

3. Çdo Shtet Kontraktues ose grup Shtetesh Kontraktuese mund të përpilojnë nëpërmjet Drejtorit të Përgjithshëm dhe në bashkëpunim me të, tekste të tjera në gjuhë të zgjedhura prej tyre.

4. Të gjitha këto tekste i shtohen atij të nënshkruar të kësaj Konvente.

Neni 17

1. Kjo Konventë nuk prek aspak dispozitat e Konventës së Bernës, për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike, si dhe në prekjen në Unionin e krijuar nga kjo Konventë.

2. Me qëllim aplikimin e nënpikës së mësipërme, këtij neni i bashkëngjitet një deklaratë, e cila bëhet pjesë e Konventës në fjalë për shtetet nënshkruese të Konventës së Bernës të 1 janarit 1951 ose ato që kanë aderuar së fundi. Nënshkrimi i kësaj Konvente nga shtete të cituara më sipër, vlen edhe si nënshkrim për deklaratën. Çdo ratifikim ose pranim i kësaj Konvente, çdo aderim në këtë Konventë nga shtete të tjera nënkupton gjithashtu edhe ratifikim, pranim ose aderim të deklaratës.

Neni 18

Kjo Konventë nuk kundërshton konventat ose marrëveshjet multilaterale ose bilaterale mbi të drejtën e autorit që mund të vendosen ndërmjet dy ose më shumë republikave amerikane, por ekskluzivisht ndërmjet tyre.

Në rast kundërshtish midis dispozitash nga njëra anë të një prej këtyre konventave ose marrëveshjeve në fuqi dhe nga ana tjetër nga dispozitat e kësaj Konvente, ose ndërmjet dispozitave të saj apo të çdo lloj konvente ose marrëveshje të re që përpilohet ndërmjet dy apo më shumë republikash amerikane. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, merret parasysh konventa ose marrëveshja më e fundit. Pa hyrjen në fuqi të kësaj Konvente në një shtet, nuk merren parasysh të drejtat e fituara mbi një vepër në bazë të konventave ose marrëveshjeve në fuqi në një nga Shtetet Kontraktuese.

Neni 19

Kjo Konventë nuk kundërshton konventat ose marrëveshjet multilaterale ose bilaterale mbi të drejtën e autorit që janë në fuqi ndërmjet dy ose më shumë Shtetesh Kontraktuese. Në rast divergjencash ndërmjet dispozitave të një prej këtyre konventave ose të një prej marrëveshjeve dhe të dispozitave të kësaj Konvente të parashikuara nuk do të preken të drejtat e fituara për një vepër në bazë të konventave apo marrëveshjeve në fuqi në një nga Shtetet Kontraktuese para hyrjes në fuqi të Konventës në fjalë në këtë shtet.

Ky nen nuk prek dispozitat e neneve 17 dhe 18.

Neni 20

Nuk pranohet asnjë rezervë për Konventën në fjalë.

Neni 21

1. Drejtori i Përgjithshëm do t'u dërgojë kopje të kësaj Konvente, të vërtetuara mirë, shteteve të interesuara, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim nën kujdesjen e këtij të fundit.

2. Drejtori i Përgjithshëm informon të gjitha shtetet e interesuara që kanë depozituar instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aderimit, për datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, për njoftimet e parashikuara për Konventën dhe denoncimet e parashikuara në nenin 14.

Deklaratë shtesë lidhur me nenin 17

Shtetet anëtare të Unionit Ndërkombëtar për mbrojtjen e veprave letrare e artistike (më poshtë

të quajtura Unioni i Bernës), pjesë e Konventës në fjalë:

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet e vazhdueshme mbi bazën e të ashtëquajturit Union dhe për evitimin e çdo konflikti që mund të rezultojë gjatë bashkekzistencës së Konventës së Bernës e Konventës Universale mbi të drejtën e autorit;

me njohjen e domosdoshmërisë se për disa shtete ka ardhur koha të adoptojnë shkallën e tyre të mbrojtjes të së drejtës së autorit në nivelin e zhvillimit kulturor, social dhe ekonomik, me një marrëveshje të përbashkët kanë pranuar termat e deklaratës së mëposhtme:

a) Me rezervë të dispozitave të pikës (b), veprat të cilat, sipas Konventës së Bernës, kanë njohur si vend të origjinës një vend i cili është larguar nga Unioni i Bernës pas 1 janarit të 1951, këto vepra nuk do të mbrohen nga Konventa Universale mbi të drejtën e autorit në vendet e Unionit të Bernës.

b) Në rastet kur një Shtet Kontraktues konsiderohet si një vend në zhvillim, konform praktikës së përpiluar nga Asambleja e Përgjithshme e Shteteve të Bashkuara dhe ka depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë, në momentin e tërheqjes së tij nga Unioni i Bernës, një njoftim ku deklaron që ky vend konsiderohet në zhvillim, dispozitat e pikës (a) nuk aplikohen aq gjatë sa ky shtet, konform dispozitave të nenit 5 bis, mund të nxjerrë si arsye përjashtimet e parashikuara nga Konventa në fjalë.

c) Konventa Universale mbi të drejtën e autorit nuk aplikohet, në raportet midis vendeve të lidhura nga Konventa e Bernës, përsa i përket mbrojtjes së veprave, të cilat në termat e kësaj Konvente të Bernës, kanë si origjinë një nga vendet e Unionit të Bernës.

REZOLUTA LIDHUR ME NENIN 11

Konferenca e rishikimit të Konventës Universale mbi të drejtën e autorit, duke konsideruar problemet lidhur me komitetin ndërqeveritar, parashikuar në nenin 11 të kësaj Konvente me të cilën kjo rezolutë i është bashkëngjitur vendosi si më poshtë vijon:

1. Komiteti do të përfshijë fillimisht përfaqësues të dymbëdhjetë shteteve anëtare të komitetit ndërqeveritar krijuar sipas formulimeve të nenit 11 të Konventës së 1952 dhe rezolutës shtojcë. Në këtë komitet do të shtohen gjithashtu përfaqësues nga shtetet e mëposhtme: Algjeri, Australi, Japoni, Meksikë, Senegal, Jugosllavi.

2. Shtetet që nuk kanë qenë pjesëtare të Konventës së 1952 dhe që nuk kanë aderuar në këtë Konventë, para sesionit të parë të zakonshëm të komitetit që vjen pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, do të zëvendësohen nga shtete të tjera që do të vendosen nga komiteti, gjatë sesionit të tij të parë të zakonshëm, sipas dispozitave të nënpikës 2 dhe 3 të nenit 11.

3. Që me hyrjen në fuqi të kësaj Konvente, komiteti i parashikuar në pikën 1 do të konsiderohet si i formuar konform nenit 11 të kësaj Konvente.

4. Komiteti do të mbajë sesionin e parë brenda një afati njëvjeçar që nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente. Në vazhdim, komiteti mblidhet në sesione të zakonshme të paktën çdo dy vjet.

5. Komiteti zgjedh presidentin dhe dy zëvendësit e tij. Komiteti përpilon rregulloren e brendshme duke ndjekur principet e mëposhtme:

a) Kohëzgjatja normale e mandatit të përfaqësuesve do të jetë gjashtë vjet me rinovim të një të tretës. Çdo dy vjet, duke nënkuptuar që mandatet e para skadojnë në fund të sesionit të dytë të zakonshëm të komitetit që mblidhet pas hyrjes në fuqi të Konventës në fjalë, një e treta tjetër në sesionin e tretë të zakonshëm dhe një e treta e fundit në fund të sesionin të katërt të zakonshëm.

b) Dispozitat duke përcaktuar procedurat sipas të cilave komiteti mund, që në vendet vakante, të përcaktojë rregullat e mbarimit të mandateve të drejtën e rizgjedhjes dhe procedurat e zgjedhjes duke respektuar një ekuilibër midis domosdoshmërisë së vazhdimësisë në përbërje dhe të rotacionit në përfaqësi, si dhe konsideratat e përmendura në pikën 3 të nenit 11.

Shprehet dëshira që Organizata e Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë siguron sekretariatin e komitetit.

Nënshkruesit me pushtetin e tyre respektiv nënshkruan Konventën në fjalë.

Bërë në Paris, më 24 korrik 1971, në kopje të veçantë.

PROTOKOLL SHTESË 1

Konventës Universale mbi të drejtën e autorit, rishikuar në Paris, më 24 Korrik 1971, lidhur me mbrojtjen e veprave të personave pa kombësi ligjore dhe refugjatë.

Shtetet pjesëtare të Konventës Universale mbi të drejtën e autorit të rishikuar në Paris, më 24 Korrik 1971 (më poshtë e quajtur Konventa e 1971) dhe duke u bërë pjesë e këtij protokolli:

Janë parashikuar dispozitat e mëposhtme:

1. Personat pa kombësi ligjore dhe refugjatët, që kanë rezidencën e tyre të banimit në një Shtet Kontraktues, për aplikimin e Konventës së 1971, janë asimiluar si shtetas të këtij shteti.

2. a) Ky protokoll do të nënshkruhet dhe do t'i nënshtrohet ratifikimit ose pranimit nga shtetet nënshkruese. Në këtë protokoll mund të aderosh konform dispozitave të nenit 8 të Konventës së 1971.

b) Ky protokoll hyn në fuqi, për çdo vend, në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit, me kusht që ky shtet të bëjë pjesë në Konventën e 1971.

c) Në datën e hyrjes në fuqi të këtij protokolli, për një shtet jopjesëmarrës të këtij protokolli, shtesa 1 e Konventës së 1952, ky i fundit, i cili konsiderohet që ka hyrë në fuqi në këtë shtet.

Me besim nënshkruesit, me autorizim të plotë, nënshkruan këtë protokoll.

Bërë në Paris, më 24 korrik 1971, në frëngjisht, anglisht dhe spanjisht. Të tre tekstet kanë të njëjtën vlerë në një kopje unike depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për edukim, shkencë dhe kulturë, e cila dërgon një kopje të vërtetuar Shteteve nënshkruese, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim.

PROTOKOLL SHTESË 2

Për Konventën Universale mbi të drejtat e autorit të rishikuar në Paris, më 24 korrik të 1971 lidhur me aplikimin e saj për veprat e disa organizatave ndërkombëtare.

Shtetet pjesëmarrëse të Konventës Universale mbi të drejtën e autorit të rishikuar në Paris, më 24 korrik 1971 (më poshtë e quajtur Konventa e 1971) dhe duke u bërë pjesë e këtij protokolli.

Janë parashikuar dispozitat e mëposhtme:

1. a) Mbrojtja e parashikuar në nënpikën 1 të nenit 2 të Konventës së 1971 aplikohet për veprat e publikuara për herë të parë nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, nga institucione të specializuara të lidhura me Shtetet e Bashkuara ose nga Organizata e Shteteve Amerikane.

b) Gjithashtu, mbrojtja e parashikuar në nënpikën 2 të nenit 2 të Konventës së 1971 aplikohet edhe për organizatat ose institucionet e lartpërmendura.

2. a) Ky protokoll do të nënshkruhet pët t'iu nënshtruar ratifikimit ose pranimit nga shtetet pjesëmarrëse dhe mund të aderohet, konform dispozitave të nenit 8 të Konventës së 1971.

b) Ky protokoll hyn në fuqi për çdo shtet në datën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aderimit lidhur me të, me kusht që ky shtet të jetë pjesëtar i Konventës së 1971.

Me besim, nënshkruesit me autorizim të plotë, nënshkruan këtë protokoll.

Bërë në Paris, më 24 korrik 1971, në frëngjisht, anglisht dhe spanjisht. Të tre tekstet kanë të njëjtën vlerë në një kopje unike depozituar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për arsim, shkencë dhe kulturë, e cila iu dërgon një kopje të vërtetuar shteteve nënshkruese, si dhe Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për regjistrim.

L I GJ
Nr.9130, datë 8.9.2003

PËR AUTORITETIN PORTUAL

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të zbatojë një strategji zhvillimi në infrastrukturë, superstrukturë, pajisje, burime financiare dhe njerëzore të porteve tregtare, detare të Republikës së Shqipërisë, si një mbështetje efektive për arritjen e objektivave shoqërorë dhe ekonomikë në nivel vendor dhe rajonal, për realizimin e objektivave tregtarë konkurrues;

b) të bëjë më të frytshëm dhe më të orientuar nga ana tregtare sistemin e porteve të Shqipërisë, të rrisë konkurrencën, të ndihmojë zhvillimin ekonomik përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat, për zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe për modernizimin e porteve;

c) të shndërrojë portet nga "porte shërbimi" në "porte administruese toke", për të rritur pavarësinë tregtare të portit;

ç) të përafrojë shërbimet dhe infrastrukturën portuale sipas praktikave ndërkombëtare, për standarde të njëjta ndërmjet shteteve;

d) të sigurojë një tërësi shërbimesh të nivelit të lartë, në mënyrë të tillë që të plotësojë me një kosto të arsyeshme nevojat e përdoruesve;

dh) të garantojë një nivel të lartë sigurie dhe mbrojtjeje të mjedisit;

e) të sigurojë një shkallë të lartë pavarësie për menaxhimin e portit, si dhe për operatorë të ndryshëm, që kryejnë shërbimet në port;

ë) të sigurojë qiradhënie ose koncesion për disa pajisje të caktuara për veprimtaritë e portit;

f) të bashkërendojë veprimtaritë detare dhe sistemin e transportit.

Neni 2
Objekti

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i formës së organizimit, i rregullave të funksionimit dhe të administrimit, i marrëdhënieve me operatorët, me organet shtetërore dhe të përfaqësimit të autoritetit portual.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj gjen zbatim në portet e Republikës së Shqipërisë, që plotësojnë standardet administrative dhe që përcaktohen si të tilla me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4
Përcaktime

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Aktive të qëndrueshme, të palëvizshme" janë skela, kalata, valëthyesi, terminali, magazina, një ndërtesë tjetër a mjedis pune pranë ujërave të lundrueshme, ku realizohet drejtimi i anijes, si dhe e gjithë sipërfaqja tokësore që përdoret për veprimtarinë e portit.

2. "Arkëtimet" janë tarifat e portit dhe të ankorimit në skelë, si dhe arkëtimet e tjera që zbatohen ndaj personave dhe zotëruesve të anijeve, të ngarkesave dhe të mjeteve të transportit.

3. "Autoriteti portual" është personi juridik, që përfaqëson interesat publikë dhe administron pronën publike të përcaktuar me ligj. Ai krijohet dhe ushtron përgjegjësitë e veta brenda territoreve të porteve të hapura të Republikës së Shqipërisë.

4. "Kapiten porti" është kapiteni i portit detar, tregtar, i emëruar nga organet përkatëse.

5. "Këshilli konsultativ i portit" është këshilli i autoritetit portual, që shërben për të këshilluar bordin drejtues.

6. “Leje përdorimi” është e drejta e dhënë nga një autoritet portual për të kryer shërbime në atë port, kundrejt pagesës së lejes dhe pagesave të tjera, sipas kontratës.

7. “Mall” janë të gjitha të mirat materiale që përdoren për veprimtarinë tregtare, përveç anijes.

8. “Ministër” nënkupton ministrin përgjegjës për portet shqiptare.

9. “Operator i autorizuar në port” është personi që ka një kontratë koncesioni ose të marrjes me qira nga autoriteti portual përkatës, i cili detyrohet të ofrojë dhe të sigurojë shërbime tregtare në atë port, si dhe të grumbullojë të ardhura në emër të tij dhe të autoritetit portual.

10. “Operator i portit” është personi që ka një kontratë të vlefshme, licencë ose koncesion me autoritetin portual, i cili është i detyruar të ofrojë dhe të sigurojë shërbime tregtare në atë port.

11. “Pagesa të arkëtuara nga autoriteti portual” janë të gjitha pagesat e kryera nga operatorë ose agjentë të ndryshëm, të mbledhura nga autoritetet portuale.

12. “Pasuritë shtetërore” janë të gjitha pasuritë që administrohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

13. “Përdorues i portit” është personi që zhvillon veprimtarinë tregtare në port.

14. “Personi” është personi fizik ose juridik, që mund të jetë një shoqëri me ortakëri dhe me një organizim të përbashkët.

15. “Port administrues toke” është një port ku autoriteti portual është administrues vetëm i infrastrukturës dhe nuk përfshihet në operacionet e shërbimeve dhe të pajisjeve.

16. “Port tregtar” është një port në juridiksionin e një autoriteti portual, që zhvillon veprimtari tregtare dhe përfshin pronën e paluajtshme dhe ujërat e lundrueshme, kufijtë e të cilave përcaktohen me akte ligjore dhe nënligjore, të regjistruara në regjistrat publikë dhe përshkruhen hollësisht në rregulloret përkatëse të portit.

17. “Tarifa ndaj anijes” është çdo pagesë e kërkuar nga autoriteti portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të anijes apo agjentit të tij.

18. “Tarifa ndaj mallit” është çdo tarifë e vendosur nga autoriteti portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të mallit ose agjencive të tyre.

19. “Zotërues” nënkupton:

a) në rastin e anijes: agjentin, qiramarrësin ose kapitenin e anijes;

b) në rastin e mallrave: përveç agjentit, dërguesit, marrësit, ruajtësit të mallit, edhe transportuesin e mallit në një apo nga një pronë, e cila është në administrimin a juridiksionin e autoritetit portual.

Neni 5

Mënyra e funksionimit të autoritetit portual

Autoritetet portuale shqiptare, që funksionojnë sipas këtij ligji:

a) kanë një rëndësi strategjike në tregtinë shqiptare;

b) janë të lidhura me një linjë kryesore hekurudhore;

c) i shërbejnë ekonomisë rajonale;

ç) kanë një trafik detar të shumëllojshëm;

d) kanë burime të mjaftueshme financiare;

dh) mbajnë statusin “administrues toke” për një periudhë, në përputhje me pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji, për të ushtruar, përmes burimeve të sektorit privat, veprimtari tregtare dhe për të menaxhuar dhe kontrolluar portin, sipas përcaktimeve të bëra në statutet e tyre, në urdhëresat dhe rregulloret.

Neni 6

Autoriteti portual dhe organet shtetërore

1. Të gjitha organet shtetërore në Shqipëri, gjatë kryerjes së shërbimeve dhe detyrave në një port, në zbatim të këtij ligji, duhet:

a) të ruajnë besimin dhe sigurinë, përmes integritetit dhe profesionalizmit, në kryerjen e shërbimeve dhe të detyrave të tyre;

b) të qartësojnë, përmes rregulloreve, parimet etike, vlerat dhe sjelljet e stafit të tyre;

c) të punësojnë një staf të përgjegjshëm në aspektin profesional, etik dhe moral, në përputhje

me dispozitat e këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi.

2. Organet shtetërore që kryejnë veprimtari në një port, i cili ka statusin e autoritetit portual, bashkëpunojnë me drejtorin ekzekutiv të këtij autoriteti dhe respektojnë të gjitha aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për organizimin dhe funksionimin e portit.

Neni 7
Përgjegjësia

1. Autoriteti portual duhet të përmbushë dhe të shlyejë detyrimet që rrjedhin prej statusit të tij.

2. Autoriteti portual është i detyruar të respektojë kushtet për siguracionin e kërkuar nga rregulloret e hartuara në përputhje me shkronjën "c" të nenit 53.

Neni 8
Administrimi financiar

Administrimi financiar i autoritetit portual bëhet në përputhje me ligjet në fuqi dhe me standardet shqiptare të kontrollit financiar dhe të kontabilitetit.

KREU II
AUTORITETI PORTUAL DHE ORGANET DREJTUESE

Neni 9
Autoriteti portual

Autoriteti portual është person juridik, i cili organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të statutit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe të legjislacionit në fuqi.

Autoriteti portual mban bashkëlidhur edhe emrin e qytetit ku është porti.

Autoritetit portual i kalon e drejta e administrimit të pronës shtetërore dhe çdo e drejtë e lidhur me të, duke respektuar strukturën e organizimit si "port administrues toke", brenda një periudhe 3-vjeçare.

Neni 10
Organet e autoritetit portual

1. Organet e autoritetit portual janë:

a) Këshilli drejtues;

b) Drejtoria ekzekutive.

2. Organet e autoritetit portual ndihmohen e këshillohen nga këshilli konsultativ i portit.

Neni 11
Emërimi i anëtarëve të këshillit drejtues

1. Anëtarët e këshillit drejtues të autoritetit portual emërohen nga ministri përgjegjës për portet shqiptare, me propozimin e institucioneve përkatëse. Përbërja e këshillit është si më poshtë:

a) dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për portet shqiptare;

b) një përfaqësues nga ministria përfaqësuese e pronës shtetërore;

c) një përfaqësues nga prefektura ku ndodhet porti;

ç) një përfaqësues nga bashkia ku ndodhet porti;

d) dy përfaqësues nga sektori privat, të propozuar nga këshilli konsultativ i portit.

Këshilli konsultativ i portit mund të propozojë më shumë se 2 persona, por ministri përkatës emëron 2 prej kandidatëve.

2. Mbledhja e këshillit drejtues zhvillohet me më shumë se gjysmën e anëtarëve të këtij këshilli. Në rast largimi të anëtarëve të këshillit drejtues, zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Këshilli drejtues përcakton pagesën e anëtarëve, të kryetarit dhe të drejtorit ekzekutiv, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Anëtarët e këshillit drejtues emërohen për një afat jo më shumë se 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Anëtarët e këshillit drejtues kanë statusin e punës me kohë të pjesshme.

5. Këshilli drejtues, në mbledhjen e tij të parë, zgjedh kryetarin dhe zëvendëskryetarin. Kryetari, si rregull, zgjidhet nga përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për portet shqiptare.

Neni 12

Kriteret për emërimin e anëtarëve të këshillit drejtues

Anëtarët e këshillit drejtues duhet të kenë një stazh pune në transport mbi pesë vjet, të kenë njohuri e përvojë të gjerë për menaxhimin e biznesit, në operacionet e portit ose në marinën tregtare.

Neni 13

Papajtueshmëria me postin e anëtarit të këshillit drejtues

Anëtar i këshillit drejtues të autoritetit portual nuk zgjidhet personi që:

a) nuk është shtetas shqiptar;

b) nuk është rezident në Shqipëri;

c) është kontraktues i një përdoruesi të portit ose personi që është drejtor, nëpunës a i punësuar i kontraktuesit të përdoruesit të autoritetit portual;

ç) nuk ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga falimentimi;

d) ka qenë i dënuar për vepra penale a kundërvajtje administrative për evazion fiskal, shkelje të dispozitave të Kodit Doganor ose të veprimtarisë në port;

dh) është i përjashtuar nga shërbimi civil;

e) ka konflikt interesash me detyrën.

Neni 14

Largimi nga detyra

Ministri përgjegjës për portet shqiptare largon nga detyra anëtarin e këshillit drejtues të autoritetit portual kur:

a) e shkarkon nga detyra, për arsye se:

i) nuk vepron në përputhje me kërkesat e nenit 19;

ii) kryen vepra penale ose shkelje të dispozitave të Kodit Doganor dhe të veprimtarisë në port;

b) e liron nga detyra kur:

i) jep dorëheqjen me shkrim;

ii) i kufizohet zotësia për të vepruar ose vdes;

iii) i mbaron mandati.

Neni 15

Detyrat dhe të drejtat e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues i një porti është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së autoritetit portual të portit dhe që ushtron të drejtat mbi pronën si “port administrues i pronës”.

2. Këshilli drejtues harton, ndryshon dhe shfuqizon rregulloret e brendshme dhe vendimet që rregullojnë ecurinë e autoritetit portual.

Neni 16

Krijimi dhe veprimtaria e këshillit konsultativ

1. Autoriteti portual, në këshillim me ministrin përgjegjës për portet shqiptare, krijon një këshill konsultativ me 11 anëtarë, nga sektori privat dhe shtetëror, ku shumicën e zë sektori privat. Këshilli konsultativ këshillon këshillin drejtues të autoritetit portual, kryesisht për këto veprimtari:

a) në caktimin dhe miratimin e tarifave të një autoriteti portual dhe ndryshimet e tyre;

b) në nxjerrjen e urdhëresave, rregulloreve, kodeve, standardeve dhe rekomandimeve;

c) në marrjen e huave;

ç) në mbikëqyrjen e shumëllojshmërisë dhe të cilësisë së veprimeve dhe shërbimeve në port, për të ruajtur konkurrencën ndërmjet operatorëve të ndryshëm;

d) në çështjet që lidhen me sigurimin e portit dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Organizimi dhe funksionimi i këshillit konsultativ të portit bëhet me urdhër të ministrit përkatës.

Neni 17

Emërimi i drejtorit ekzekutiv

1. Këshilli drejtues emëron drejtorin ekzekutiv dhe zëvendësit e tij mbi bazën e propozimit të ministrit.

2. Drejtori ekzekutiv emëron nëpunësit e tjerë dhe personelin e nevojshëm për menaxhimin e portit.

3. Drejtori ekzekutiv nuk është anëtar i këshillit drejtues.

Neni 18

Përgjegjësia e anëtarëve të këshillit drejtues dhe të nëpunësve

Çdo anëtar i këshillit drejtues dhe nëpunës i autoritetit portual, gjatë ushtrimit të përgjegjësive dhe kryerjes së detyrës, duhet:

a) të veprojë me ndershmëri dhe përgjegjësi në interes të autoritetit portual;

b) të jetë profesionist në realizimin e detyrave;

c) të ndjekë objektivin e kthimit të portit në një "port administrues toke";

ç) të sigurojë përdorimin e mundësive dhe të rrisë shfrytëzimin maksimal të portit, për të plotësuar kërkesat e klientit dhe të tregut;

d) të realizojë shpërndarje të drejtë të burimeve njerëzore, teknike dhe financiare të portit.

Neni 19

Marrëdhëniet ndërmjet këshillit drejtues dhe drejtorit ekzekutiv

Drejtori ekzekutiv është përgjegjës përpara këshillit drejtues për drejtimin dhe administrimin e autoritetit portual. Ai bashkërendon punën për planifikimin dhe caktimin e burimeve të të ardhurave të departamenteve dhe të njësive të tjera.

Neni 20

Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nëpunësit

1. Përgjegjësitë e drejtorit ekzekutiv janë:

a) siguron drejtimin dhe administrimin efektiv të portit;

b) zhvillon, zbaton dhe realizon veprimtaritë e përcaktuara nga ky ligj;

c) përgatit dokumentacionin e autoritetit portual për burimet njerëzore dhe administron këto burime;

ç) përfaqëson autoritetin portual në ministrinë përkatëse dhe në marrëdhënie me të tretë;

d) siguron zbatimin e politikave të autoritetit portual dhe të kërkesave të tjera ligjore për këtë autoritet;

dh) nxit profesionalizmin dhe nivelin e lartë të stafit;

e) siguron të dhëna për këshillin drejtues për çështjet që lidhen me autoritetin portual;

ë) kontribuon në hartimin e politikave që synojnë rritjen e frytshme të autoritetit portual dhe vë në dijeni këshillin drejtues për këto politika;

f) zbaton detyra të tjera të caktuara nga këshilli drejtues.

2. Nëpunësit e njësive të tjera janë përgjegjës përballë drejtorit ekzekutiv.

3. Drejtori ekzekutiv është menaxheri i përgjithshëm i autoritetit portual dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga këshilli drejtues, duke i raportuar drejtpërdrejt atij.

4. Drejtori ekzekutiv zbaton politika për forcimin e autoritetit portual dhe të përgjegjësive, qartëson stafin për nivelin e punës së tyre dhe kryen detyrat publike, duke ruajtur mirëbesimin, integritetin dhe profesionalizmin e shërbimeve të kryera në port.

5. Drejtori ekzekutiv, në mbështetje të kërkesave, i jep leje për të hyrë në port çdo personi që ushtron veprimtari në port.

Neni 21
Mbledhja e këshillit drejtues

1. Këshilli drejtues, si rregull, mblidhet 1 herë në tre muaj.

2. Këshilli drejtues i autoritetit portual zhvillon mbledhjen vjetore jo më vonë se një muaj pas mbylljes së llogarive të autoritetit portual.

3. Mbledhjet vjetore të autoritetit portual janë të hapura për publikun dhe çdo mbledhje tjetër që gjykohet prej tij.

4. Autoriteti portual bën njoftim në gazetën kryesore (të paktën 30 ditë para mbledhjes), ku përcakton orën dhe vendin ku do të mbahet mbledhja dhe krijon mundësinë që pasqyrat financiare t'u vihen në dispozicion pjesëmarrësve.

5. Në mbledhjen vjetore këshilli drejtues siguron:

a) numrin e mjaftueshëm të kopjeve të pasqyrave financiare të autoritetit portual për personat e pranishëm në mbledhje;

b) që drejtori ekzekutiv dhe anëtarët e këshillit drejtues t'u përgjigjen pyetjeve të pjesëmarrësve për veprimtarinë e portit.

KREU III
USHTRIMI I VEPRIMTARISË

Neni 22
Veprimtaritë

1. Autoriteti portual, nëpërmjet drejtorit ekzekutiv, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mëposhtme:

a) veprimtarinë portuale për transportin e mallrave, lundrimin (drejtimin e anijeve), transportin e pasagjerëve, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;

b) veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të përshkruara në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni.

2. Drejtori lidh kontrata në emër të autoritetit portual.

Neni 23
Marrja e kredisë

1. Autoriteti portual mund të marrë kredi vetëm për qëllime të portit. Propozimi i marrjes së kredisë diskutohet paraprakisht nga këshilli konsultativ i portit dhe miratohet nga këshilli drejtues.

2. Propozimi për marrjen e kredisë për investime bazohet në studimet ose analizat që përcaktojnë përparësitë e projekteve të studiuara dhe masat e fizibilitetit.

3. Autoriteti portual nuk mund të hipotekojë apo të lërë si garanci pronën shtetërore që menaxhon ose administron. Ai mund të lërë si garanci të ardhurat e asaj prone.

Neni 24
Investimet

1. Ministri mund të kërkojë fonde nga Buxheti i Shtetit për investime në rehabilitimin dhe

modernizimin e infrastrukturës dhe të superstrukturës së portit, për të arritur objektivat strategjikë, të përcaktuar në nenet 1 dhe 51 të këtij ligji. Ministri përkatës, për zgjerimin, rehabilitimin ose modernizimin e portit, përdor fondet e buxhetit të miratuar për ministrinë përkatëse në marrëveshje me autoritetin portual.

2. Autoriteti portual, për arritjen e objektivave të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji, ndërmerr masat e nevojshme për të investuar me fondet e veta në zgjerimin, modernizimin dhe rehabilitimin e infrastrukturës portuale.

Neni 25

Publikimi i pasqyrave financiare

1. Autoriteti portual vë në dispozicion të publikut (të paktën 30 ditë para mbledhjes) pasqyrat financiare të vitit fiskal pararendës, të miratuara nga këshilli drejtues, në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit.

2. Pasqyrat vjetore financiare tregojnë pagesën e përgjithshme që i është bërë secilit prej personave të mëposhtëm, përfshirë këtu dhe ndonjë pagesë në formën e ndihmës financiare ose të ndonjë përfitimi tjetër:

a) anëtarëve të këshillit drejtues;

b) drejtorit ekzekutiv;

c) nëpunësit dhe punonjësit, kur shuma kalon limitet e planifikuara.

3. Autoriteti portual i paraqet ministrit pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare.

4. Drejtori ekzekutiv, në emër të autoritetit portual, në çdo mbledhje vjetore është i detyruar të paraqesë:

a) pasqyrat financiare krahasuese;

b) raportin e ekspertit kontabël të autorizuar;

c) ndonjë të dhënë tjetër për pozitën financiare të autoritetit portual.

5. Pasqyrat financiare, që u paraqiten pjesëmarrësve, kontrollohen nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe miratohen nga këshilli drejtues.

Neni 26

Librat e llogarive dhe sistemet

1. Autoriteti portual:

a) ruan librat e llogarive dhe raportet llogaritëse;

b) siguron që kontrolli financiar dhe menaxherial, sistemet e informacionit dhe praktikat menaxheriale të jenë në përputhje me ligjet në fuqi.

2. Librat e llogarive, regjistrimet, sistemet dhe praktikat mbahen dhe përpunohen, në mënyrë që të japin garanci se:

a) aktivet e autoritetit portual janë të siguruara dhe të kontrolluara;

b) veprimet e autoritetit portual janë në përputhje me ligjet në fuqi;

c) burimet njerëzore, financiare dhe fizike të autoritetit portual janë menaxhuar në mënyrë të frytshme dhe se operacionet e autoritetit portual janë kryer realisht.

Neni 27

Plani i biznesit

Autoriteti portual i paraqet ministrit për miratim një plan biznesi 3 deri 5-vjeçar, i cili azhurnohet çdo vit. Plani i biznesit mund të përmbajë të dhëna si:

a) një pasqyrë ku përshkruhen objektivat e planit të biznesit;

b) një strategji marketingu;

c) parashikimet e veprimtarive të anijeve dhe të ngarkesave;

ç) planin e zhvillimit të infrastrukturës portuale;

d) planin e veprimeve;

dh) planin e zhvillimit të burimeve njerëzore;

e) sistemet informuese dhe plani;

ë) planin e thithjes dhe të investimit të kapitalit;

f) planin financiar dhe marrëveshjet financiare, përfshirë dhe huamarrjet;

g) ndonjë material lidhur me ndryshimet.

Pasqyrat financiare dhe plani i biznesit përgatiten në mënyrë të tillë që të japin të dhëna të qarta për çdo veprimtari të autoritetit portual.

Neni 28

Kontrolli i autoritetit portual

1. Organet përkatëse shtetërore të kontrollit ushtrojnë kontroll mbi autoritetin portual për të përcaktuar nëse veprimet e tij janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Kontrolli analizon sistemet dhe praktikat e autoritetit portual.

Neni 29

Raportet për kontrollin

1. Në përfundim të kontrollit, organi përkatës i paraqet këshillit drejtues dhe ministrit një raport me përfundimet e kontrollit.

2. Raporti përmban një pasqyrë, kur vërehet se nuk ka mangësi të rëndësishme në sistemet dhe praktikat e kontrolluara.

Neni 30

Përgjegjësitë dhe detyrimet

1. Për të gjitha pronat e patundshme që administron autoriteti portual, është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë për pronën, sipas ligjeve në fuqi.

2. Një veprim juridik civil, penal ose administrativ i kryer me pronën shtetërore që autoriteti portual administron, merret nga vetë autoriteti portual.

Neni 31

Dhënia me koncesion

1. Dhënia e koncesionit, e lejes së përdorimit për ndonjërën nga pronat shtetërore ose për pronat e autoritetit portual, për të rritur konkurrencën portuale, si rregull, bëhet në përputhje me legjislacionin për koncesionet.

2. Autoriteti portual harton kritere të qarta për kualifikimin, përvojën, performancën dhe kriteret e dhënies me koncesion, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Dhënia e koncesionit, e lejes së përdorimit ose dhënies me qira të objektit bëhet nga këshilli drejtues, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, pas miratimit nga komisionet teknike dhe financiare në këshillim me këshillin konsultativ të portit.

4. Autoriteti portual ushtron përgjegjësitë sipas pikave 1 dhe 3 të këtij neni dhe mund të kryejë e të shpërndajë dokumentet e kërkuara për atë qëllim.

Neni 32

Të drejtat mbi pronën shtetërore

1. Autoriteti portual nuk mund të shesë asnjërën nga pronat shtetërore që administron, por mund:

a) të ofrojë lehtësi, të japë të drejta ose leje për shërbimet ose të krijojë mundësi për t'i përdorur ato;

b) të shesë pajisjet dhe të hartojë dokumentacionin e kërkuar për atë qëllim;

c) të sigurojë territoret tokësore dhe ujore për zgjerimin e portit, për t'i ardhur në ndihmë veprimtarisë së portit.

2. Autoriteti portual kryen dhe shpërndan dokumentet e kërkuara, për qëllim të shkronjave

“a”, “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni.

Neni 33
Ndikimet e planit të administrimit të tokës

1. Plani i administrimit të tokës mund:

a) të ndalojë administrimin e pronës shtetërore për qëllime të caktuara (p.sh. magazinimin e substancave dëmtuese);

b) të ndalojë vendosjen e objekteve që pengojnë punën në port;

c) të rregullojë modelin e strukturave ose të veprimtarive që mund të krijohen;

ç) të identifikojë zonat që autoriteti portual ka ndër mend të marrë për kryerjen e veprimtarive të portit dhe funksione të tjera, që i mbështesin këto veprimtari.

2. Autoriteti portual, për hartimin ose rishikimin e një plani për administrimin e tokës, mbështetet në ligjet në fuqi dhe në standardet ndërkombëtare. Plani duhet të përmbajë dispozitat për rishikime, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ndryshimet e strategjisë së zhvillimeve të portit.

3. Autoriteti portual publikon në gazetë njoftimin për çdo ndryshim të planit të administrimit të tokës.

4. Autoriteti portual miraton planin, pasi ka marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet e bëra nga personat e interesuar. Plani i administrimit të tokës, i miratuar sipas këtij ligji, është një dokument detyrues.

Neni 34
Hekurudhat në porte

1. Autoriteti portual lidh, kur i kërkohet, marrëveshje edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Hekurudhave, për t’i lejuar asaj përdorimin e tokës.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave:

a) mban të siguruar, gjatë gjithë kohës, sistemin hekurudhor të portit, në kushte funksionimi;

b) është përgjegjëse për drejtimin e stafit të vet dhe për qarkullimin e sigurt të mjeteve hekurudhore.

KREU IV
TARIFAT

Neni 35
Përcaktimi i tarifave

1. Autoriteti portual cakton tarifat për:

a) anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;

b) ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar brenda kufijve të portit ose magazinimin në port;

c) shërbimet që sigurohen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar, ose ndonjë të drejtë të dhënë prej tij, në lidhje me portin.

2. Autoriteti portual cakton normën e interesit që kërkon për pagesat e vonuara.

3. Tarifat e përcaktuara nga autoriteti portual, sipas pikës 1, janë në një nivel që i lejojnë atij të veprojë në baza vetëmbështetëse financiare dhe ato duhet të jenë të arsyeshme dhe të favorshme.

4. Kur tarifat janë propozuar nga një operator që punon në port, autoriteti portual, pas këshillimit me këshillin konsultativ të portit, caktojnë një kufi më të lartë të këtyre tarifave.

5. Tarifat tavan, të propozuara nga autoriteti portual, në përputhje me pikën 4, nuk duhet të rrezikojnë arritjet ekonomike dhe financiare të operuesit.

Neni 36
Përgjegjësia për tarifat

1. Tarifat dhe interesat, të përcaktuara sipas këtij ligji, për anijet dhe ngarkesat paguhen nga

zotëruesi ose personi që e ka në ngarkim anijen ose mallin dhe mblidhen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar.

2. Tarifat dhe interesi, të përcaktuara sipas këtij ligji, për mjetet e transportit paguhen nga zotëruesi i mjetit dhe mblidhen nga autoriteti portual ose nga një operator i autorizuar.

Neni 37
Paanësia

1. Kur cakton tarifat, autoritetit portual ose operatorit të autorizuar nuk i lejohet të shkelë barazinë e subjekteve përdoruese.

2. Nuk përbën diskriminim, nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave a të sasisë së të mirave që tregtohen apo mbi baza të tjera, që nga ana tregtare janë të pranueshme për një person të licencuar që ka të drejtën e caktimit të tarifave.

Neni 38
Njoftimi për tarifat e reja ose të rishikuara

1. Kur autoriteti portual ose operatori i autorizuar vendos tarifa të reja apo rishikon tarifat ekzistuese për magazinimin ose ankorimin, ai nuk lejohet të bëjë dallime ndërmjet përdoruesve, si dhe duhet të njoftojë për tarifat e propozuara. Tarifat e reja hyjnë në fuqi pas 60 ditëve nga data e botimit të njoftimit në gazetë.

2. Njoftimi duhet:

a) të përmbajë hollësitë e tarifave të propozuara;

b) të specifikojë tarifën, që do të merret nga autoriteti portual;

c) të specifikojë adresën se ku duhet të paraqiten personat e interesuar.

3. Autoriteti portual duhet:

a) ta botojë njoftimin në gazetën kryesore me tirazh më të lartë, që del në Republikën e Shqipërisë;

b) t'u dërgojë me postë ose me mjete elektronike njoftim organizatave, anëtarët e të cilave ndikohen drejtpërdrejt nga tarifat e reja.

Neni 39
Ankesat

1. Çdo person i interesuar ka të drejtën e ankimimit pranë drejtorit ekzekutiv, kur mendon se janë bërë dallime në vendosjen e tarifave.

2. Drejtori ekzekutiv është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankesës.

KREU V
SHËRBIMI I MBROJTJES SË MJEDISIT DHE I SIGURISË

Neni 40
Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit

1. Autoriteti portual i portit për mbrojtjen e mjedisit në port krijon shërbimin e kualifikuar të mbrojtjes së mjedisit dhe ndan përgjegjësitë e këtij shërbimi.

2. Autoriteti portual përcakton detyrat e këtij shërbimi.

3. Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit regjistron të gjitha rastet e veprimeve që cenojnë mjedisin dhe zbaton rregulloret, vendimet dhe udhëzimet e autoritetit portual, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, me sistemet dhe praktikat e pranuara nga

shteti shqiptar për mbrojtjen e mjedisit dhe të tokës së portit.

4. Detyrat e shërbimit të mbrojtjes së mjedisit përfshijnë:

a) hartimin e planeve të kontingjencës, si dhe të rregulloreve për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja gjatë transportimit, lëvizjes ose magazinimit të substancave që përbëjnë rrezik për mjedisin;

b) pjesëmarrjen në përgatitjen e planit të biznesit dhe të planit të përdorimit të tokës.

5. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit, si rregull, çdo vit, por edhe për çdo rast ndotjeje, i paraqet këshillit drejtues një raport të hollësishëm për problemet mjedisore të portit.

Neni 41
Shërbimi i sigurisë

1. Autoriteti portual i portit, për të siguruar personat nga rreziku për jetën dhe plagosja dhe për të siguruar materialet nga dëmtimi ose humbja në portet e Shqipërisë, krijon shërbimin e sigurisë dhe cakton stafin e nevojshëm. Shërbimi i sigurisë ndjek rregulloret dhe udhëzimet e autoritetit portual, derisa ato nuk e pengojnë atë për kryerjen e detyrimeve ligjore.

2. Shërbimi i sigurisë regjistron të gjitha aksidentet e ndodhura dhe zbaton rregulloret dhe udhëzimet e hartuara sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe sistemet e praktikat e pranuara nga shteti shqiptar për mbrojtjen e personave dhe të materialeve në port.

3. Detyrat e shërbimit të sigurisë përfshijnë:

a) përgatitjen e rregulloreve të sigurisë për transportimin, lëvizjet ose magazinimin e eksplozivëve a të substancave të tjera që përbëjnë rrezik për jetën dhe pronën;

b) përgatitjen e planeve dhe të rregullores së sigurisë për personat dhe mjetet e transportit në port;

c) sugjerimet për përgatitjen e planit të biznesit dhe të planit të përdorimit të tokës.

4. Shërbimi i sigurisë i paraqet këshillit drejtues çdo vit një raport për problemet e sigurisë.

Neni 42
Bashkërendimi i detyrave

1. Personeli i shërbimit të mbrojtjes së mjedisit dhe i shërbimit të sigurisë, të emëruar nga autoriteti portual, duhet të bashkërendojnë detyrat e tyre me Kapitenerinë e Përgjithshme të Porteve dhe me organizmat e tjerë, rajonalë ose kombëtarë, përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe për sigurimin industrial.

2. Bashkërendimi kryhet përmes linjave zyrtare të komunikimit ndërmjet autoritetit portual dhe Kapitenerisë së Përgjithshme të Porteve të Shqipërisë dhe ndiqet nga shërbimi i sigurimit të portit, shërbimi i mbrojtjes së mjedisit dhe stafi përgjegjës i kapitenerisë së portit.

3. Nëpunësi i mbrojtjes së mjedisit dhe nëpunësi i sigurisë janë përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurisë në zonën tokësore, ndërsa kapiteni i portit është përgjegjës për zonën ujore të portit dhe për anijet.

4. Në rast mosmarrëveshjesh, për çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, ndërmjet nëpunësit të sigurisë dhe atij të mbrojtjes së mjedisit të autoritetit portual dhe të kapitenerisë së portit, ndërhyn Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve, vendimi i së cilës është i detyrueshëm.

KREU VI
NDALIMI I ANIJEVE

Neni 43
Bllokimi

1. Bllokimi i mjeteve lundruese në territorin e portit bëhet vetëm me vendim të gjykatës, përveç rasteve kur me ligj parashikohet ndryshe.

2. Autoriteti portual mund t'i kërkojë trupit gjykues të lëshojë një urdhërndalim për një anije ose për materialet e ngarkuara në anije, nëse autoriteti portual vërteton se:

a) zotëruesi i anijes ose i mallrave ka shkelur këtë ligj;

b) zotëruesi i mallit duhet të paguajë shumën për tarifat a për interesin e vënë sipas këtij ligji;

c) është dëmtuar prona për faj të anijes ose të pakujdesisë së ekuipazhit të saj.

KREU VII
PËRGJEGJËSI TË TJERA

Neni 44
Garancia e pagesës

1. Autoriteti portual ose një operator i autorizuar ka të drejtën të mbajë anijen ose të ardhurat nga shitja e saj si garanci për shumën që anija i detyrohet, dhe konkretisht kjo shumë ka lidhje me:

a) tarifat dhe interesin që duhet të shlyejë anija për qëndrimin e saj ose për mallrat e ngarkuara në të;

b) dëmtimin e pronës nga anija ose nga ekuipazhi i saj.

2. Autoriteti portual ose një operator i autorizuar mund të marrë si garanci mallra për shumën që i duhet të paguajë anija për tarifat dhe interesat.

3. Kur mallrat e mbajtura për garanci janë mallra që prishen, autoriteti portual mund t'i shesë me çmim të arsyeshëm dhe të ardhurat kreditohen për të shlyer pagesën që duhet paguar për anijet dhe mallrat.

Neni 45
Largimi i anijeve ose i mallrave

1. Kur autoriteti portual mendon se një anije ose mallrat e lëna a të "braktisura" brenda zonës së përcaktuar bëhen pengesë ose paraqesin vështirësi dhe pasiguri për zonën, atëherë kapiteneria e portit, me kërkesë të autoritetit portual, urdhëron personin që ka në zotërim anijen ose mallrat, t'i largojë ato në një zonë të përshtatshme.

2. Kur një person nuk e largon anijen ose mallrat, ose kur nuk shfaqet asnjë person si zotërues i anijes a i mallrave, atëherë kapiteni i portit ndalon anijen ose mallrat dhe i zhvendos ato në një vend tjetër. Kostoja e ndalimit dhe e zhvendosjes i ngarkohen zotëruesit të anijes ose të mallrave.

KREU VIII
KUNDËRVAJTJET DHE DËNIMET

Neni 46
Kundërvajtjet

1. Kur nuk përbëjnë kundërvajtje penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) moslëvizja në kohë dhe mosvendosja në vendin e caktuar e mjeteve detare që pengojnë ose vështirësojnë veprimtarinë e përditshme të portit dënohen me gjobë nga 200 000 deri në 700 000 lekë;

b) qëndrimi i mjeteve tokësore, automobilistike dhe hekurudhore në vende që pengojnë ose vështirësojnë veprimtarinë e përditshme të portit dënohen me gjobë:

i) për personat fizikë nga 20 000 deri në 50 000 lekë;

ii) për personat juridikë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

2. Personi nuk dënohet për kundërvajtje nëse ai vërteton se ka ushtruar kujdesin e duhur për të parandaluar kryerjen e saj.

3. Kur një person vazhdon të kryejë të njëjtën shkelje edhe pas dhënies së dënimit për kundërvajtje, autoriteti portual i jep të njëjtën masë dënimi për çdo ditë që vazhdon shkelja.

4. Masat për kundërvajtjen mund të merren në çdo kohë, por jo më vonë se 1 vit pas kryerjes së kundërvajtjes administrative.

Neni 47
Vendosja e gjobës dhe e drejta e ankimit

1. Dënimet me gjobë, të parashikuara në nenin 45, vendosen nga agjentët kontrollues, të

caktuar nga drejtori ekzekutiv.

2. Kundër dënimit administrativ me gjobë bëhet ankim te drejtori ekzekutiv brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit.

3. Drejtori ekzekutiv është i detyruar ta shqyrtojë ankesën dhe të kthejë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e ankimit.

4. Kundër vendimit të drejtorit dhe në rastin kur ai nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e dhënies së dënimit administrativ.

KREU IX
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 48
Anëtarët e mëparshëm të këshillit drejtues

Anëtarët e këshillit drejtues të autoritetit portual, të emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të kryejnë detyrën e tyre deri në zgjedhjen e anëtarëve të rinj, në përputhje me këtë ligj.

Neni 49
Dispozitat kalimtare

1. Këshilli i Ministrave, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore, që rregullojnë marrëdhëniet e autoritetit portual me organet shtetërore që kryejnë detyra funksionale në territorin e portit.

2. Ministri, brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të miratojë planin e investimeve dhe të zhvillimit.

3. Autoriteti portual, brenda një viti pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë rregulloret e kërkuara, në përputhje me nenin 16 të këtij ligji.

4. Autoriteti portual, brenda 6 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, të nxjerrë dhe të vërë në zbatim rregulloret e kërkuara, në përputhje me pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 50
Prona dhe detyrimet

1. Prona që administron porti, në formën e organizimit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe çdo e drejtë ose detyrim që lidhet me të, i kalon autoritetit portual me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që kanë lindur për portin para hyrjes në fuqi të këtij ligji, i kalojnë autoritetit portual.

Neni 51
Plani i administrimit të tokës

1. Autoriteti portual, brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, është i detyruar të hartojë një plan të ri ose ta azhurnojë planin ekzistues, të hollësishëm, të administrimit të tokës, i cili përmban objektivat dhe politikat për zhvillimin material të pronës shtetërore që administron.

2. Plani i administrimit të tokës miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të autoritetit portual.

Neni 52
Tarifat

Tarifat që janë në fuqi, në lidhje me portin, mbeten të tilla edhe për një periudhë gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 53
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore përkatëse në zbatim të nenit 3, nenit 9 pika 4 dhe nenit 31 pika 2.

2. Ministri, në zbatim të këtij ligji, ngarkohet të nxjerrë urdhra dhe udhëzime për këto çështje:

a) të përcaktojë se ku mund të investojë porti;

b) të përcaktojë nivelin e pagesave, sipas nenit 25 pika 2;

c) të mbulojë siguracionet që mund të zbatojë një autoritet portual.

Neni 54
Shfuqizimi

Të gjitha dispozitat e akteve ligjore dhe nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 55
Hyrja në fuqi e ligjit

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3968, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9131, datë 8.9.2003

PËR RREGULLAT E ETIKËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të vendosë rregullat e sjelljes së nëpunësve të administratës publike, sipas standardeve të kërkuara, t'i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standardeve dhe të vërë në dijeni publikun për sjelljen që duhet të ketë nëpunësi i administratës publike.

Neni 2
Fusha e veprimit

1. Dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjithë nëpunësit e administratës publike

për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në dispozita të tjera ligjore.

2. Dispozitat e këtij ligji përbëjnë detyrim për të zgjedhurit, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe gjyqtarët.

3. Dispozitat e këtij ligji përbëjnë detyrim edhe për personat e punësuar nga organizatat private që kryejnë shërbime publike.

4. "Nëpunës i Administratës Publike", në kuptim të këtij ligji janë të gjithë personat e punësuar pranë një institucioni të administratës publike.

Neni 3
Parime të përgjithshme të etikës

1. Në kryerjen e funksioneve, nëpunësi i administratës publike duhet të respektojë parimet si më poshtë:

a) të kryejë detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike e të mos pengojë zbatimin e politikave, të vendimeve ose veprimeve ligjore të autoriteteve të administratës publike;

c) në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;

ç) të jetë i sjellshëm në marrëdhënie me qytetarët që u shërben, dhe me eprorët, kolegët e vartësit e tij;

d) nuk duhet të veprojë arbitrarisht në dëm të një personi ose organizate dhe duhet të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personalë të të tretëve;

dh) të mos lejojë që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmangë konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;

e) të sillet gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet;

ë) të ruajë konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr.8503, datë 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".

2. Këshilli i Ministrave nxjerr rregulla në zbatim të parimeve të treguara në pikën 1 të këtij neni.

KREU II
KONFLIKTET E INTERESAVE

Neni 4
Konflikti i interesave

1. Konflikti i interesave është situata në të cilën një nëpunës i administratës publike ka një interes personal të tillë, që ndikon ose mund të ndikojë në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare.

2. Interesat personalë të nëpunësit përfshijnë çdo përparësi për veten, familjen, të afërmit deri në shkallën e dytë, personat ose organizatat, me të cilat nëpunësi ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose lidhje politike. Konflikti i interesave përfshin, gjithashtu, çdo lloj detyrimi financiar ose civil të nëpunësit.

3. Kur nëpunësi ka dijeni se një situatë e tillë ekziston, ai është i detyruar që:

a) të verifikojë nëse ka një konflikt aktual të mundshëm interesash;

b) të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur një konflikt të tillë;

c) të vërë në dijeni menjëherë, me nismën e tij, eprorin direkt dhe njësinë e personelit për konfliktin aktual ose të mundshëm të interesave;

ç) në rast dyshimi për gjendjen në një situatë konflikti interesash, të këshillohet me eprorin direkt ose/dhe me njësinë e personelit të institucionit;

d) t'i bindet çdo vendimi përfundimtar për të mos marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes ose të heqë dorë nga përparësitë, që shkakton konflikti.

4. Konfliktet e mundshme të interesit të një kandidati për t'u punësuar në administratën publike duhet të zgjidhen përpara emërimit të tij.

Neni 5
Shmangia e konfliktit të interesave

1. Eprori direkt, me mbështetjen e njësisë së personelit, në bazë të të dhënave që ka, merr masat e nevojshme që të shmanget emërimi i një nëpunësi në pozicione, në të cilat mund të lindin ose ka konflikte interesash ose që nëpunësit të mos i ngarkohen detyra që mund të çojnë në shfaqjen e një konflikti të mundshëm interesash.

2. Shmangia e konfliktit të interesave bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

3. Nëpunësi, i cili ka interesa të tillë, që vazhdimësia e zotërimit të tyre do të përbënte rrezik real për lindjen e konfliktit të interesave dhe do të sillte përjashtimin e vazhdueshëm nga veprimtaria e tij zyrtare ose pamundësinë për të ushtruar detyrat zyrtare, duhet të heqë dorë ose t'i transferojë këta interesa, në mënyrë të tillë që mundësia e konfliktit të interesave të shmanget.

KREU III
VEPRIMTARI TË JASHTME TË NËPUNËSIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE

Neni 6
Veprimtaritë e jashtme

Me veprimtari të jashtme të nëpunësit kuptojmë çdo lloj veprimtarie të rregullt ose të rastësishme, që kërkon angazhimin e nëpunësit të administratës publike, qoftë për qëllime fitimi ose jo, që nëpunësi zhvillon jashtë detyrës zyrtare.

Neni 7
Ndalimi i veprimtarive të jashtme

1. Nëpunësi publik nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme, që pengon kryerjen e detyrës së tij zyrtare ose që kërkon një angazhim, mendor a fizik të tij që e bën të vështirë kryerjen e detyrës, ose është vazhdim i kësaj detyre, që cenon, në çfarëdo mënyre, imazhin e nëpunësit të administratës publike.

2. Në rast dyshimi për kualifikimin e një veprimtarie si të lejueshme ose jo, nëpunësi këshillohet me njësinë e personelit të institucionit.

3. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e klasifikimit të një veprimtarie të jashtme si të lejueshme ose jo.

Neni 8
Lejimi i veprimtarive të jashtme

1. Kryerja e veprimtarive të jashtme duhet t'i njoftohet paraprakisht eprorit direkt të nëpunësit të administratës publike, dhe njësisë së personelit.

2. Veprimtaritë, në kuadër të veprimtarive sindikale ose të përfaqësimit të punëmarrësve ose veprimtaritë mësimdhënëse, janë të lejueshme kur ato nuk pengojnë në kryerjen e detyrës.

Neni 9
Shpërblimi për veprimtaritë e jashtme

Nëpunësi nuk mund të shpërblehet për veprimtaritë e jashtme kur ato kanë të bëjnë me detyrat që ai ka kryer në ushtrim të funksioneve të tij ose janë vazhdimësi e drejtpërdrejtë e tyre, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në akte të tjera ligjore ose nënligjore.

KREU IV
PËRFITIMET

Neni 10
Dhuratat dhe favoret

1 Nëpunësi i administratës publike nuk duhet të kërkojë ose të pranojë, dhurata, favore, pritje ose çfarëdo përfitim tjetër, ose shmangie të humbjeve të mundshme, si dhe premtime për to, për veten, familjen, të afërmit, personat ose organizatat me të cilat ka marrëdhënie, që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrës, apo janë ose duket sikur janë shpërblim për mënyrën e kryerjes së detyrës zyrtare.

2. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet në rastin e ftesave të zakonshme, të mikëpritjes tradicionale, të dhuratave me vlerë simbolike ose tradicionale, të mirësjelljes, të cilat nuk krijojnë dyshime mbi paanshmërinë e nëpunësit.

3. Në rast dyshimi mbi paanshmërinë e përfitimeve, nëpunësi këshillohet me njësinë e personelit të institucionit.

Neni 11
Reagimi ndaj ofertave

1. Në qoftë se nëpunësit i ofrohet një avantazh i padrejtë, ai duhet:

a) ta refuzojë, pa pasur nevojë ta pranojë atë për ta përdorur si provë;

b) të përpiqet që ta identifikojë personin që i bën ofertën;

c) të shmangë kontaktet e gjata me personin që bëri ofertën, por dijenia e arsyes për të cilën bëhet oferta, mund të shërbejë si provë;

ç) në qoftë se dhurata nuk mund të refuzohet që t'i kthehet dërguesit, duhet të ruhet, të përdoret sa më pak që të jetë e mundur dhe t'i raportohet menjëherë eprorit direkt;

d) të ketë dëshmitarë, nëse është e mundur, kolegët që punojnë me të;

dh) të raportojë përpjekjen, sa më shpejt që të jetë e mundur, tek eprori i tij ose te njësia e personelit;

e) të vazhdojë punën normalisht, sidomos për problemin për të cilin avantazhi i padrejtë është ofruar.

2. Këshilli i Ministrave përcakton vlerën e dhuratave që mund të pranohen nga nëpunësi dhe mënyrën e administrimit të dhuratave që nuk mund të kthehen.

KREU V
DETYRIME TË TJERA GJATË PERIUDHËS SË PUNËSIMIT NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Neni 12
Detyrime të nëpunësit të administratës publike

Nëpunësi i administratës publike nuk duhet ta përdorë ose të lejojë ta përdorin detyrën zyrtare të tij, në mënyrë të tillë që të nxisë ose të detyrojë ndonjë person tjetër, përfshirë edhe vartësit, për të pasur ndonjë përfitim financiar ose të çdo lloji tjetër me interes personal.

Neni 13
Prona shtetërore

1. Nëpunësit duhet të mbrojnë dhe ruajnë pronën e institucionit, përfshirë këtu edhe dokumentacionin zyrtar. Nëpunësi nuk duhet të përdorë ose të lejojë që të përdoret prona që institucioni zotëron ose ka në përdorim, për asnjë qëllim tjetër, përveçse për kryerjen e veprimtarive të miratuara, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Nëpunësi duhet të përdorë mjetet që i ofron pozicioni i punës vetëm për realizimin e detyrave të tij dhe jo për qëllime personale.

Neni 14
Koha e punës

Nëpunësi duhet ta përdorë kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave zyrtare. Kjo kohë nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, përveçse në rastet kur përdorimi i saj për qëllime të tjera është i autorizuar zyrtarisht, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 15
Paraqitja e nëpunësit

Veshja dhe paraqitja e nëpunësit duhet të jenë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht administratën publike.

Rregullat e hollësishme për veshjen dhe paraqitjen e nëpunësve në institucionet e administratës publike përcaktohen nga rregulloret e brendshme të institucioneve.

KREU VI
PERIUDHA PAS PUNËSIMIT

Neni 16
Përdorimi i informacionit

Nëpunësit e administratës publike pas largimit nga detyra nuk duhet ta përdorin informacionin konfidencial, të marrë gjatë kryerjes së detyrës, për interes personal.

Neni 17
Ndalimi i përfaqësimit në konfliktet me administratën publike

Për një periudhë kohe 2-vjeçare, pas largimit nga detyra, ish-nëpunësi nuk duhet të përfaqësojë asnjë person ose organizatë në një konflikt ose marrëdhënie tregtare me administratën publike shqiptare, për detyrën që ai ka kryer ose në vazhdimësi të saj.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18
Dispozitë zbatuese

1. Njësia e personelit është e detyruar t'i bëjë të ditur nëpunësit në çastin e punësimit të tij detyrimet që rrjedhin nga ky ligj dhe që duhen respektuar nga nëpunësi.

2. Nëpunësi ka për detyrë të sillet në përputhje me këtë ligj dhe, për këtë arsye, informohet për dispozitat e tij dhe për çdo ndryshim ose shtesë.

3. Nëpunësi duhet të kërkojë këshillim nga njësia e personelit të institucionit kur është i pasigurt për të vepruar. Njësia e personelit të institucionit, për raste të veçanta, këshillohet edhe me Departamentin e Administratës Publike.

4. Dispozitat e këtij ligji janë pjesë e kushteve të punësimit të nëpunësit. Shkelja e tyre bëhet shkak për marrjen e masave disiplinore.

5. Eprori direkt i nëpunësit të administratës publike ka përgjegjësi të kontrollojë nëse ai zbaton rregullat e treguara në këtë ligj dhe të propozojë ose të marrë masat e duhura disiplinore për shkeljet e tij.

Neni 19
Masat disiplinore

Nëpunësit që shkelin parimet e etikës, të përcaktuara në këtë ligj, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, ndëshkohen me masat disiplinore, sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin për statusin e nëpunësit civil.

Neni 20
Regjistrimi i masave

1. Çdo institucion i administratës publike duhet të komunikojë pranë Departamentit të Administratës Publike çdo masë disiplinore të marrë ndaj një punonjësi brenda 10 ditëve nga marrja e masës.
2. Departamenti i Administratës Publike i regjistron të gjitha masat disiplinore në Regjistrin Kombëtar të Administratës Publike.

Neni 21
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 7 e 11 të këtij ligji.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3967, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

L I G J
Nr.9132, datë 11.9.2003

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË KOMBINUAR TË MALLRAVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Bullgarisë për transportin ndërkombëtar të kombinuar të mallrave”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.3969, datë 29.9.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË BULLGARISË MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR TË KOMBINUAR TË MALLRAVE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë,
këtu e më poshtë të quajtura "Palë Kontraktuese":
me dëshirën për të lehtësuar transportin ndërkombëtar të mallrave;
duke pasur parasysh që efiçenca e transportit ndërkombëtar të mallrave është një kusht i rëndësishëm për marrëdhëniet tregtare;
duke njohur që për mbrojtjen e ambientit dhe për të krijuar alternativa të pranueshme në aspekte ekonomike, sociale dhe ambientale të transportit rrugor të mallrave do të zhvillohet një sistem modern transporti duke përdorur avantazhet e transportit hekurudhor, lundrimit të brendshëm dhe detar;
të bindur që sistemi i transportit të kombinuar ka aftësi të mëdha për të lehtësuar transportin ndërkombëtar të mallrave;
bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
Dispozita të përgjithshme

1. Marrëveshja aktuale do të aplikohet për transportin ndërkombëtar të kombinuar të mallrave në njësi të transportit intermodal ose mjete rrugore, të transportuara nëpërmjet hekurudhës dhe/ose rrugëve ujore të brendshme dhe/ose detit dhe pjesërisht nëpërmjet rrugëve, të kryera nga transportuesit, të regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese, me drejtim ose pikë destinacioni në të njëjtin territor, duke përfshirë transitin direkt nëpërmjet tij, si dhe nëpërmjet territorit të Palës tjetër Kontraktuese.
2. Marrëveshja aktuale nuk do të ndikojë të drejtat dhe detyrimet të rrjedhura nga marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat marrin pjesë Palët Kontraktuese.

Neni 2

Për qëllimet e Marrëveshjes aktuale:
a) Transport intermodal i mallrave do të nënkuptojë lëvizjen e mallrave në një dhe në të njëjtën njësi të transportit intermodal ose mjet rrugor, që përdor dy ose më shumë mënyra transporti të njëpasnjëshme pa shkarkimin e vetë mallrave gjatë ndërrimit të mënyrave.
b) Transporti ndërkombëtar i kombinuar i mallrave do të nënkuptojë transportin intermodal të mallrave, ku pjesa më e madhe e udhëtimit bëhet nëpërmjet hekurudhës, rrugëve të brendshme ujore ose detit dhe çdo pjese fillestare dhe/ose përfundimtare e kryer nëpërmjet rrugëve janë sa më të shkurtra që të jetë e mundur.
c) Mjet rrugor do të nënkuptojë çdo mjet të motorizar, të projektuar dhe të përdorur për transportin rrugor të mallrave. Bashkimi i një kamioni dhe një traileri ose i një koke tërheqëse dhe një semi-traileri, kur kamioni ose koka tërheqëse është regjistruar në një nga Palët Kontraktuese konsiderohet gjithashtu si një mjet rrugor.
d) Njësia e transportit intermodal do të nënkuptojë kontenierin, shasinë, semi- trailerin ose trailerin, të përshtashëm për transportin intermodal.
e) Terminal intermodal do të nënkuptojë vendin në rrjetin hekurudhor ose në rrugët ujore të

brendshme në portin e lumit ose të detit, ku kryhet ndërrimi i mënyrës.

f) Transporti për në/nga terminali intermodal do të nënkuptojë segmentin rrugor të udhëtimit të njësisë së transportit intermodal nga pika e kalimit kufitar ose pika e nisjes për në terminalin më të afërt rrugor, hekurudhor ose port dhe nga një terminal hekurudhor ose port për në pikën më të afërt të kalimit rrugor kufitar ose për në destinacionin e mallrave.

g) Transporti i kombinuar i shoqëruar do të nënkuptojë transportin e mjeteve të kompletuara rrugore, të shoqëruara nga shoferi duke përdorur një mënyrë tjetër transporti.

h) Transporti i kombinuar i pashoqëruar do të nënkuptojë transportin e mjetit rrugor ose e një njësie transporti intermodal, të pashoqëruar nga shoferi, duke përdorur një mënyrë tjetër transporti.

i) Kuota bonus do të nënkuptojë numrin e lejeve rrugore pa pagesë të taksave/detyrimeve rrugore të lëshuara si një përfitim për kryerjen e një numri të caktuar të udhëtimeve të transportit të kombinuar.

j) Territori i Palës Kontraktuese do të nënkuptojë territorin e Republikës së Shqipërisë, respektivisht territorin e Republikës së Bullgarisë.

k) Komiteti i përbashkët do të nënkuptojë komitetin e përbashkët mbi transportin e kombinuar ndërkombëtar, të vendosur në përputhje me nenin 7 të Marrëveshjes aktuale.

Neni 3

Transport i kombinuar i shoqëruar i mallrave

1. Lëvizja e mjeteve rrugore, të regjistruara në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, ndërmjet pikës shtetërore të kalimit kufitar ose pikës së destinacionit në territorin e Palës tjetër Kontraktuese dhe një terminali intermodal në këtë territor, do të kryhet pa leje dhe mjetet rrugore do të përjashtohen nga detyrimet rrugore për një distancë të caktuar të miratuar më parë ndërmjet autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese. Autoritetet e kontrollit të transportit në kufijtë shtetërorë do të lënë të kalojnë pa leje mjetet rrugore, që mbajnë një dokument, i cili siguron të drejtën e kryerjes së transportit të mallrave.

2. Në rast se distanca e përmendur në paragrafin e mësipërm është tejkaluar, një transport i tillë do të kryhet mbi bazën e një leje speciale. Leja speciale do të lëshohet nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese. Leje speciale do të tregojë që i referohet transportit të kombinuar, që ajo është me ose pa pagesë të taksave rrugore dhe që është e vlefshme vetëm për këtë udhëtim transporti.

3. Kuota e lejeve për transportin e shoqëruar (tipi dhe numri), e përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, do të vendoset mbi bazën e reciprocitetit në një komitet të përbashkët.

4. Kuota e lejeve, të përcaktuara nga komiteti i përbashkët, do të vendoset çdo 6 (gjashtë) muaj. Çdo modifikim i kësaj kuote do të pranohet në përputhje me nevojat e transportit të Palëve Kontraktuese.

5. Palët Kontraktuese do të përpiqen të sigurojnë që koha e pushimit të trenave Ro-La në pikat e kalimit kufitar nuk i kalon tridhjetë (30) minuta.

Neni 4

Transporti i pashoqëruar

1. Transporti i njësive të transportit intermodal për në/nga një intermodal në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese do të kryhet nga mjete rrugore, të regjistruara në territorin e të njëjtës Palë Kontraktuese .

2. Transporti i njësive të transportit intermodal për në/nga një terminal intermodal në territorin e njërës Palë Kontraktuese mund të kryhet nga mjete rrugore të regjistruara në territorin e Palës tjetër Kontraktuese mbi bazën e një leje speciale të lëshuar nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në territorin e të cilës kryhet transporti.

3. Transportuesi mund të kryejë transport të pashoqëruar për në/nga një terminal duke siguruar që ai është dorëzuesi i mallrave ose ai është i autorizuar për këtë nga kompania e transportit të kombinuar.

4. Terminale intermodale, që mund të përdoren për transport të tillë do të përcaktohen gjatë një sesioni të komitetit të përbashkët.

Neni 5

Kalimet kufitare - kalimi i kufirit shtetëror

1. Kur mjeti rrugor që kryen transport të kombinuar për transportin ndërkombëtar të mallrave, ngarkohet në një tren ose në një anije, do të ketë dokumentet e kërkuara në përputhje me rregullat ndërkombëtare në fuqi.

Dokumentet që japin të drejtën për të kryer transport të kombinuar të mallrave do të mbahen në mjet gjatë udhëtimit dhe do të tregohen me kërkesën e autoriteteve kompetente të njërës nga Palët Kontraktuese.

Në rastin e mungesës së një dokumenti të tillë, mjeti do të konsiderohet pa leje dhe do të trajtohet si i tillë.

Çdo modifikim ose korrigjim i paautorizuar mbi dokumentin e transportit shkakton eliminimin e tij. Dokumente të tilla transporti do të konfiskohen kundrejt lëshimit të një dokumenti përkatës.

2. Në rastin e transportit të kombinuar të shoqëruar të mallrave, gjatë hyrjes në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, në kufirin shtetëror autoritetet kompetente do të lejojnë kalimin e transportuesve dhe mjeteve rrugore të cilat kanë një dokument, i cili garanton të drejtën për të kryer transport të kombinuar të mallrave, në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje. Gjatë largimit nga territori i njërës prej Palëve Kontraktuese, kryerja e transportit të kombinuar do të njihet me një dokument transporti p.sh. letër dorëzimi CIM-UIRR, policë ngarkese ose dokument tjetër të miratuar nga të dyja Palët Kontraktuese.

3. Gjatë hyrjes ose largimit nga kalimi i kufirit shtetëror të njërës prej Palëve Kontraktuese, personat dhe mjetet që kryejnë transport të kombinuar të mallrave dhe mallrat do të jenë subjekt kontrolli në përputhje me rregullat e legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese respektive.

4. Transportuesi ose operatori i shërbimit, si dhe të punësuarit që udhëtojnë me të do të jenë të detyruar të respektojnë legjislacionin në fuqi në territorin e Palës Kontraktuese respektive.

Neni 6

Nxitja e transportit të kombinuar të mallrave

1. Palët Kontraktuese do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që administratat e tyre, kompanitë hekurudhore, portuale dhe detare, transportuesit dhe operatorët rrugorë të transportit të kombinuar të bien dakord për masat urgjente që mbështesin transportin e kombinuar të mallrave, duke pasur parasysh avantazhet që siguron ky transport.

2. Pala Kontraktuese do të asistojë në nxitjen dhe përmirësimin e shërbimit, si dhe në rritjen e aftësive konkurruese të transportit të kombinuar të kryer nga kompani transporti në fushën e transportit hekurudhor, rrugor, të rrugëve të brendshme ujore dhe atij detar dhe nga operatorë të transportit të kombinuar, që justifikojnë përdorimin e transportit të kombinuar të pashoqëruar dhe prezantojnë tarifa stimuluese të përshtatshme.

3. Palët Kontraktuese do të sigurojnë mbështetje të plotë për kompanitë e tyre hekurudhore dhe administratën portuale për të asistuar në zhvillimin e infrastrukturës së tyre për transportin e kombinuar.

4. Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme, në mënyrë që mjetet rrugore që kryejnë transport të kombinuar të mallrave për në/nga terminalet e transportit të kombinuar në territorin e shteteve të tyre të mos jenë subjekt i pengesave të transportit të aplikuara të shtunave, të dielave dhe në festat kombëtare.

5. Palët Kontraktuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar kushte për kalimin e mjeteve rrugore me peshë totale deri në 44 ton në segmentin fillestar dhe përfundimtar të udhëtimit të transportit të kombinuar.

6. Palët Kontraktuese do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për të përshpejtuar procedurat e kontrollit kufitar për transportin e kombinuar dhe do të ndikojnë në transferimin e kontrollit kufitar nga pikat e kalimeve kufitare në terminalet intermodale (në rrjetin hekurudhor dhe në portë).

7.Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë dhe kooperojnë për vendosjen e kushteve favorizuese ndërkombëtare për të stimuluar transportin e kombinuar dhe do të marrin masa për të stimuluar zhvillimin e rrugëve me përdorim të përbashkët.

8. Komiteti i përbashkët mbi transportin e kombinuar do të vendosë kuotën e udhëtimeve të kryera të transportit dhe kuotën bonus të lejeve të transportit rrugor për shërbimet Ro-La dhe Ro-Ro brenda kuadrit të transportit të kombinuar ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese dhe transit përmes territoreve të tyre, të kryera nga mjete rrugore të regjistruara në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 7

Bashkëpunimi dhe komiteti i përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese (Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Transportit dhe e Komunikacioneve të Republikës së Bullgarisë) do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për zbatimin dhe aplikimin e Marrëveshjes aktuale, si dhe për shkëmbimin reciprok të të gjithë informacionit të përdorshëm. Autoritetet kompetente do të informojnë në kohën e duhur njëri-tjetrin të çdo amendamendi të legjislacionit kombëtar, në lidhje me transportin e kombinuar, si dhe të ndonjë amendamenti në lidhje me fuqinë vepruese të autoritetit respektiv kompetent. Autoritetet kompetente do të bashkëpunojnë në zbatimin e Marrëveshjes aktuale.

2. Çdo debat i cili lidhet me aplikimin e Marrëveshjes aktuale do të zgjidhet nga komiteti i përbashkët, i cili do të vendoset nga Palët Kontraktuese mbi propozimet e autoriteteve të tyre përkatëse. Çdo Palë Kontraktuese do të caktojë përfaqësuesit e saj në komitetin e përbashkët brenda tridhjetë (30) ditëve mbas datës të hyrjes në fuqi të Marrëveshjes aktuale. Kryetarët e Palëve Kontraktuese do të kenë të drejtën të ftojnë ekspertë të tjerë në komitetin e përbashkët.

3. Sesionet e komitetit të përbashkët do të mbahen me kërkesën e kryetarit të njërës prej Palëve Kontraktuese.

4. Komiteti i përbashkët do të ketë të drejtën të propozojë amendamente të Marrëveshjes aktuale.

Neni 8

Shkelja e dispozitave

1. Në rastin e shkeljeve të rregullave në fuqi në territorin e Palës tjetër Kontraktuese nga transportuesi, operatori dhe të punësuarit e tyre, si dhe në rastin e shkeljes së dispozitave të Marrëveshjes aktuale, me kërkesë të autoriteteve kompetente të Palës Kontraktuese ku ka ndodhur shkelja, autoritetet kompentente të Palës tjetër Kontraktuese do të kenë të drejtën të ndërmarrin një nga veprimet e mëposhtme:

a) të njoftojnë transportuesin, i cili ka kryer shkeljen që të respektojë rregullat në fuqi;

b) të ndërpresë lëshimin e licencave speciale dhe bonusin për këtë transportues;

c) të anulojë vlefshmërinë e licencave speciale dhe bonusit, tashmë të lëshuara për një periudhë kohe;

d) në veçanti kur kryhen shkelje serioze nga transportuesi dhe/ose operatori, të anulojë licencën e tyre vepruese dhe t'i pengojë ata të kryejnë këtë aktivitet nëpërmjet kanaleve të përshtatshme.

2. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën mbi veprimet e ndërmarra.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk pengojnë aplikimin e legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese në territorin e të cilës është kryer shkelja.

Neni 9

Mbrojtja e të dhënave

1. Palët Kontraktuese deklarojnë që çdo e dhënë dhe informacion, me përjashtim të të dhënave statistikore zyrtare dhe raporteve, janë të mbrojtura ndaj shpërndarjes së paautorizuar për palët e treta.

2. Të dhënat dhe informacioni mund t'u ofrohet autoriteteve shtetërore kompetente, prokurorisë dhe gjykatës, në qoftë se kërkohet në një procedurë kriminale. Çdo e dhënë tjetër do të shpërndahet vetëm me një autorizim të pranuar me shkrim të autoriteteve kompetente të Palës tjetër

Kontraktuese.

Neni 10
Forcat madhore

Në rastin e forcave madhore, si rezultat i të cilave transporti i kombinuar i mallrave është ndërprerë për një periudhë më shumë se 12 orë, Palët Kontraktuese do të marrin masa të përbashkëta urgjente.

Neni11
Hyrja në fuqi

Marrëveshja aktuale do të hyjë në fuqi 30 ditë pas datës të marrjes së notës së dytë diplomatike, me anë të së cilës Palët Kontraktuese informojnë njëra-tjetrën se janë kryer të gjitha kërkesat e legjislacionit të tyre kombëtar për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes aktuale.

Neni 12
Amendamentet e Marrëveshjes

Marrëveshja aktuale mund të amendohet mbi bazat e aprovimit të përbashkët me shkrimin të Palëve Kontraktuese. Amendamentet do të hyjnë në fuqi në përputhje me parashkimin e nenit 11 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni13
Periudha e veprimit

Marrëveshja aktuale mund të përfundojë për një periudhë të pacaktuar kohe dhe çdo Palë Kontraktuese mund ta denoncojë atë me shkrim. Kjo Marrëveshje do të përfundojë efektin e saj 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së një note diplomatike me anë të së cilës Pala tjetër Kontraktuese njofton aktin e denoncimit.

Në dëshmi të nënshkruesve, të autorizuar plotësisht për këtë nga qeveritë e tyre kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Nënshkruar në Tiranë, më 26.3.2003 në dy (2) kopje origjinale në gjuhët shqip, bullgarisht dhe anglisht, të cilat janë të barasvlefshme.

Në rast të një mosmarrëveshje në interpretim, teksti anglisht do të mbizotërojë.

U D H Ë Z I M
Nr.1, datë 15. 8.2003

PËR RAPORTIMIN E GJENDJES NUMERIKE TË DRURËVE FRUTORË DHE DOKUMENTET QË DUHEN PLOTËSUAR PËR LEJIMIN E PRERJES SË TYRE.

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.7929, datë 11.5.1995 “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit

UDHËZON:

1. Raportimi i gjendjes numerike të drurëve frutorë.

1.1. Raportimi i gjendjes numerike të drurëve frutorë në ngastra, blloqe e të shpërndara bëhet

nëpërmjet inventarit periodik dhe evidencës së përvitshme.

1.2. Inventari periodik i gjendjes numerike të drurëve frutorë realizohet nëpërmjet inventarizimit të përgjithshëm e të kadastrimit që bëhet me urdhër të posaçëm të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit.

1.3. Evidenca e përvitshme pasqyron ndryshimet e gjendjes së drurëve frutorë çdo vit dhe bëhet duke u mbështetur:

- në gjendjen e një viti më parë;
- në pakësimet gjatë vitit raportues që ndodhin nga tharjet natyrale, shkuljet, prerjet që kanë ardhur për arsye të ndryshme ose ndryshim të destinacionit të tokës;
- në shtesat që realizohen nga zëniet e rezultuara të mbjelljeve të reja gjatë sezonit të mbjelljeve që i përket vitit raportues.

1.4. Evidenca e përvitshme e drurëve frutorë plotësohet nga drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit, të cilën e dërgojnë në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit më 31 dhjetor të çdo viti, sipas modelit nr.1 bashkëngjitur, të shoqëruar me një relacion shpjegues për argumentimin e pakësimeve dhe shtesave.

1.5. Për realizimin e raportimit të gjendjes numerike të drurëve frutorë, drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit, në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor, krijojnë regjistrat e fondit të drurëve frutorë (me specie e varietete) për çdo fshat, komunë dhe/ose bashki dhe në shkallë qarku, ku vazhdimisht pasqyrohen ndryshimet e ndodhura si më poshtë:

a. Pakësimet në rrënjë dhe sipërfaqe, sipas rastit:

- prerje e shkulje me leje;
- prerje e shkulje pa leje, të evidentuara;
- prerje e shkulje për ndërtime publike, për të cilat ka legjislacion të posaçëm;
- tharje natyrale nga mosha e sëmundjet e dëmtuesit, të evidenturara;
- shkulje e tharje nga rrëshqitjet e tokës etj;
- nga ndryshimet e destinacionit të tokës, etj.

b. Shtesat në rrënjë dhe sipërfaqe, sipas rastit:

- zëniet që rezultojnë sipas të dhënave që mbahen për mbjelljet e reja;
- sipërfaqja e tokës (ngastra e blloqe) që kthehet me destinacion për drurët frutorë me mbjelljet e reja.

2. Dokumentet që duhen plotësuar për lejimin e prerjes së drurëve frutorë.

2.1. Për lejet që janë në kompetencë të Drejtorisë së Prodhimit Bimor dhe Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit, për prerjet (shkuljet) e ullinjve, koleksioneve të pemëve frutore, agrumeve dhe vreshtave, si dhe të bimëve drufrutore të vetmuara e të regjistruara për vlerat e veçanta gjenetike, fermerët, personat fizikë e juridikë paraqesin këto dokumente:

a. Kërkesën (sipas modelit të dërguar me rregulloren "Për mbrojtjen e drurëve frutorë").

b.Vërtetimin nga kryepleqësia e fshatit për pronësinë dhe argumentimin e prerjes ose shkuljes.

c. Lejen e ndërtimit të dhënë nga organi kompetent, në rastet e ndërtimeve publike apo private.

d. Raportin teknik të një grupi specialistësh të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe të Ushqimit e të komunës dhe/ose bashkisë.

e. Miratimin nga Instituti i Pemëtarisë dhe Banka Gjenetike për rastet e koleksioneve dhe bimëve të regjistruara për vlera të veçanta gjenetike.

Mbështetur në dokumentet e sipërpërmendura, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe e Ushqimit i propozon zyrtarisht Drejtorisë së Prodhimit Bimor dhe Mbrojtjes së Bimëve në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit për dhënien e lejeve.

Brenda 15 ditëve nga arritja e propozimit, Drejtoria e Prodhimit Bimor dhe Mbrojtjes së Bimëve bën verifikimet e nevojshme dhe jep përgjigje zyrtare.

2.2. Për lejet që janë kompetencë e Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë dhe të Ushqimit për prerje e shkulje:

- të mbi 0.1 ha pemishte, agrumishte e vreshta dhe
- të arrës në të gjitha rastet,

fermerët, personat fizikë e juridikë paraqesin këto dokumente:

a. dokumentet sipas germave a, b dhe c të pikës " 2.1";

b. raportin teknik të specialistit të degës së bujqësisë në komunë dhe/ose bashki.

Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit, Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe e

Ushqimit, pasi bën verifikimet e nevojshme, jep përgjigje zyrtare.

2.3. Për lejet që janë në kompetencë të specialistit të degës së bujqësisë në komunë dhe/ose bashki, për prerjen apo shkuljen e:

- e pemëve frutore e agrumeve të shpërndara të pemishteve e vreshtave deri në 0.1 ha, fermerët, personat fizikë dhe juridikë paraqesin dokumentet sipas gërmave "a", "b" të pikës "2.1".

Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së subjektit dhe dokumenteve shoqëruese, specialisti i degës së bujqësisë në komunë dhe/ose bashki pas verifikimeve të nevojshme, jep përgjigje zyrtare.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE I USHQIMIT
Agron Duka

_____.
(Emertimi i Rajonit ku ushtron veprimtarine drejtoria rajonale e bujqesise dhe ushqimit)

Model nr. 1

Evidenca vjetore e gjendjes numerike te drufrutorëve per vitin ..... .

Nr.	Speciet dhe varietetet e bimeve drufrutore.	Gjendja e raportuar 31 dhejtor .....,(1 vit me pare).			1. Pakesime gjate vitit raportues			2. Shtesa nga zëniet e Rezultuara te mbjelljeve te reja te vitit raportues.			Gjendja ne fund te vitit Raportues, me 31dhjetor		
		Gjithsej	Ne ngastra e blloqe		Gjithsej	Ngastra e blloqe		Gjithsej	Ngastra e blloqe te reja.		Gjithsej	Ne ngastra e blloqe	
		000/ rr	dynym	000/ rr	000/ rr	dynym	000/rr	000/ rr	dynym	000/ rr	000/ rr	dynym	000/rr
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
I	PEME FRUTORE												
1.	Molle gjithsej												
	Varietetet.....												
2.	Dardhe												
	Varietetet.....												
3.	Ftonj												
4.	Kumbull												
5.	Qershi												
6.	Vishnje												
7.	Pjeshke												
	Varietetet....												
	Nga pjeshka:Nektarinë												
	Varietetet.....												
8.	Kajsi												
9.	Fiq												
10.	Hurma (Kaki)												
11.	Shege												
12.	Mushmolle dimrore												
13.	Nespola												
14.	Mana per koker												
15.	Geshtenja												
16.	Arra												
17.	Bajame												
18.	Lajthi te kultivuara												
19.	Luleshtrydhe te kultivuara												
20.	Mjedhra te kultivuara												
21.	Thana te kultivuara												
22.	Kiwi (Aktinidie)												

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
II.	ULLINJ GJITHSEJ												
1.	Per kripje												
	Varietetet.....												
2.	Per vaj												
	Varietetet.....												
3.	Per kripje e vaj												
	Varietetet.....												
III.	AGRUME GJITHSEJ												
1.	Portokalle												
	Varietetet												
2.	Mandarina												
	Varietetet												
3.	Limona												
	Varietetet												
4.	Agrume tjera												
IV.	PJERGULLA + EREKE												
1.	Varietete per rrush tavoline												
	Varietetet												
2.	Varietete per rrush vere												
	a. Per vere te kuqe												
	Varietetet												
	b. Per vere te bardhe												
	Varietetet												
V.	VRESHTA PER RRUSH												
1.	Varietete per rrush tavoline												
	Varietetet.....												
2.	Varietete per rrush vere.												
	a. Per vere te kuqe												
	Varietetet												
	b. Per vere te bardhe												
	Varietetet												
VI.	VRESHTA "MËMË" ANTI-FILOKSERIKE (per nenshartesa)												
	Varietetet.....												

Shënim : Ne rregjistrat qe do mbahen per çdo fshat, komune e rreth dhe ne evidencen vjetore që do dergohet zyrtarisht ne Ministrine e Bujqesise dhe Ushqimit do te perfshini te gjitha speciet e kultivuara dhe varietetet qe evidentohen.Per raste qe nuk dihen te perfshihen ne varietete te tjera.

KËRKESË

Shtetësja Merita Daneja, e datëlindjes 1973, banuese në Gramsh, kërkon të shpallet i zhdukur bashkëshorti i saj Fatos Daneja.

KËRKUESE
Merita Daneja

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

Kodi Penal *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Mars, 2002	**Kodi i Procedurës Penale** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Shtator, 2002	**Kodi i Procedurës Civile** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Korrik, 2002	**Kodi Civil** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Shtator, 2003	**Kodi Rrugor** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Qershor,2002
Kodi Penal Ushtarak *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Tetor, 2002	**Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Tetor, 2002	**Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Shtator, 2003	**Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Shtator, 2003	**Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë** *Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare* Shtator, 2003

Doli nga shtypi më 6.10.2003

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë